Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

United Nations ALBANIA

UNFPA

RAPORT

MONITORIMI I DEKLARATËS
"ÇFARË KËRKOJNË TË RINJTË E TIRANËS?"

Nënshkruar në 9 nëntor 2015
nga Kryetari i Bashkisë së Tiranës



SHTATOR 2019

Leave No One Behind

Observatori për te drejtat e fëmijëve dhe te rinjve

Autor:
Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve

© Aplikimet për leje për të shumëfishuar ose përkthyer pjesë nga ky raport monitorimi duhet të dërgohen në:

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve
Rr. "Blv. Bajram Curri" Nd. 136, H. 14, Ap. 1
Njësia Administrative Nr 5, 1019, Tiranë, Shqipëri
Tel: 00355 42 258 987
Email: info@observator.org.al
Webmail: www.observator.org.al

EKSPERTE E ANALIZËS
Monika Kocaqi

EKIPI MENAXHUES
Elma Tërshana
Eridjona Vallja
Andi Rabiaj

SUPERVIZUESE
Elida Nuri

Ky raport monitorimi u realizua nga Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA) me ekspertizën e Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve (Observatori), në emër të Rrjetit të Organizatave "Zëri i të rinjve", në kuadër të projektit "Leave No One Behind" ("Askush të mos mbetet pas"), një Program i përbashkët i Kombeve të Bashkuara i financuar nga Agjensia Zviceriane për Zhvillim e Bashkëpunim (SDC) dhe zbatuar nga katër agjensi të Kombeve të Bashkuara: UNDP, UNFPA, UNICEF, dhe UN WOMEN në partneritet me qeverinë shqiptare. Ky projekt synon fuqizimin e personave vulnerabël në Shqipëri që të kenë akses të barabartë në shërbimet dhe mundësitë publike, të kenë një zë në vendimmarrjen publike që ndikon në jetën e tyre dhe t'u kërkojnë llogari zyrtarëve publikë, duke i mbajtur përgjegjës për dështimet apo arritjet.

Përmbajtja e këtij raporti monitorimi është përgjegjësi e Observatorit, në emër të Rrjetit të Organizatave "Zëri i të Rinjve". Opinionet e shprehura këtu janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionet e UNFPA-së, Kombeve të Bashkuara apo SDC-së.

FALENDERIME

"Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve" (Observatori[1]) në emër të Rrjetit të Organizatave "Zëri i të Rinjve[2]" dëshiron të falenderojë të gjithë personat që u përfshinë në dhënien e informacionit dhe materialeve të domosdoshme për realizimin e procesit të monitorimit të zbatimit të Deklaratës "Çfarë kërkojnë të rinjtë e Tiranës?", si dhe për përgatitjen e këtij raporti monitorimi.

Falenderojmë punonjësët dhe punonjësit e Bashkisë Tiranë që mundësuan dhënien e informacionit dhe materialeve burimore të domosdoshme për monitorimin; falenderojmë të rinjtë anëtarë të Bordit Këshillimor Rinor për ndarjen e përshtypjeve të tyre mbi mënyrën e organizimit dhe funksionimit të këtij Bordi; falenderojmë të rejat dhe të rinjtë e mbështetur nga Bashkia Tiranë në kuadër të nxitjes së sipërmarrjeve rinore, punësimit apo ideve kreative, për ndarjen e eksperiencave të tyre në lidhje me mbështetjen e përfituar; njëkohësisht falenderojmë stafin e Bashkisë Tiranë, e në mënyrë të veçantë Kryetarin e Bashkisë *z. Erion Veliaj*, për mbajtjen në konsideratë dhe trajtimin me prioritet të çështjeve të ngritura nga të rejat dhe të rinjtë e Tiranës, siç u paraqitën në Deklaratën e nënshkruar për këtë qëllim në vitin 2015, *znj. Anisa Ruseti*, Nënkryetare e Bashkisë së Tiranës si dhe *znj. Aspasjana Kërxhalli*, Drejtore e Rinisë në Bashkinë e Tiranës, për vënien në dispozicion të materialeve dhe informacionit të nevojshëm për realizimin e këtij monitorimi.

Falenderime të veçanta i shkojnë ekipit të punës për kontributin dhe ekspertizën e ofruar në përgatitjen dhe finalizimin e gjithë procesit të monitorimit, *znj. Monika Kocaqi* që u angazhua për përgatitjen e metodologjisë, mjeteve monitoruese dhe shkrimin e raportit të monitorimit, *znj. Elma Tërshana*, Drejtore Ekzekutive dhe Koordinatorëve të Rrjetit të Organizatave "Zëri i të Rinjve" *znj. Eridjona Vallja* dhe *z. Andi Rabiaj*.

Një falenderim i veçantë shkon për gjithë stafin e UNFPA-së në Shqipëri, sidomos për *znj. Manuela Bello* dhe *znj. Elida Nuri* për mbështetjen e vazhdueshme të dhënë që nga momenti i krijimit të Rrjetit të Organizatave "Zëri i të rinjve", e në mënyrë të veçantë për përgatitjen e Deklaratës "Çfarë kërkojnë të rinjtë e Tiranës?" dhe hedhjen e hapave të mëtejshëm deri në monitorimin e zbatimit të saj.

[1] www.observator.org.al
[2] http://jotabu.al/rreth-organizatave/

SHKURTIME

Deklarata	Deklarata “Çfarë kërkojnë të rinjtë e Tiranës”
INSTAT	Instituti i Statistikave
MASR	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
MMSR	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtes Sociale
Observatori	Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
PKVR	Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015-2020
PLVR	Plani Lokal i Veprimit për të Rinjtë 2018-2020
Rrjeti	Rrjeti i organizatave “Zëri i të rinjve”
SDC	Agjensia Zviceriane për Zhvillim e Bashkëpunim
SDG	Objektivat e Zhvillimit të Qendrueshëm
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNFPA	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
UN Women	Agjensia e Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Gruas

TABELA E PËRMBAJTJES

FALENDERIME 3
SHKURTIME 4
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 6
1. HYRJE DHE PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM 10
1.1. DEKLARATA "ÇFARË KËRKOJNË TË RINJTË E TIRANËS?" 10
1.2. PËRSHKRIM I SITUATËS NË MOMENTIN E NËNSHKRIMIT TË DEKLARATËS 11
2. METODOLOGJIA DHE PROCESI I MONITORIMIT 13
3. REZULTATET 14
3.1. PËRPJEKJET E PËRGJITHSHME TË BASHKISË NË ADRESIMIN E ANGAZHIMEVE TË NDËRMARRA 14
3.2. ARRITJET NË LIDHJE ME "NXITJEN E SIPËRMARRJES RINORE" 17
3.3. ARRITJET NË LIDHJE ME "KRIJIMIN E BORDIT RINOR KËSHILLIMOR TË BASHKISË TIRANË" 21
4. KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET 23
4.1 KONKLUZIONET 23
4.2. REKOMANDIMET 24
5. SHTOJCA 26
5.1. DEKLARATA "ÇFARË KËRKOJNË TË RINJTË E TIRANËS?" 26
5.2. PLANI I MONITORIMIT TË DEKLARATËS 33
5.3. PYETËSORI I TË RINJVE 37

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport u përgatit nga Observatori në emër të Rrjetit të Organizatave "Zëri i të Rinjve", në kuadër të monitorimit të zbatimit të Deklaratës "Çfarë kërkojnë të rinjtë e Tiranës?". Deklarata[3] u nënshkrua në nëntor të vitit 2015 nga Kryetari i Bashkisë Tiranë dhe përmban pesë çështje kryesore të ngritura nga të rejat dhe të rinjtë e Tiranës, për t'u adresuar dhe përmbushur nga Bashkia Tiranë.

Të dhënat mbi monitorimin e zbatimit të angazhimeve të ndërmarra nga Bashkia Tiranë përmes nënshkrimit të Deklaratës u mblodhën nga Observatori përgjatë periudhës kohore tetor 2018 – shtator 2019, sikurse ishte parashikuar edhe në planin e monitorimit të përgatitur për këtë qëllim, që në momentin e nënshkrimit të Deklaratës. Ky informacion u plotësua dhe përditësua edhe gjatë periudhës kohore janar – mars 2019.

Meqenëse treguesit e parashikuar në këtë plan monitorimi ishin *tregues procesi*, edhe monitorimi vetë u realizua në këtë formë pra ***monitorim i procesit*** apo arritjeve të deritanishme. Të dhënat e mbledhura janë të natyrës cilësore dhe mjetet e monitorimit të përdorura për këtë qëllim ishin kryesisht intervistat e thelluara të zhvilluara me 10 (dhjetë) të reja dhe të rinj të cilat/cilët kanë përfituar mbështetje nga Bashkia Tiranë në kuadër të nxitjes së sipërmarrjeve rinore, punësimit apo ideve kreative, si dhe me 2 (dy) të rinj anëtarë të Bordit Këshillimor Rinor, të ngritur pranë Bashkisë Tiranë. Pjesa tjetër e informacionit të nevojshëm për procesin e monitorimit u nxorr nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Bashkia Tiranë.

Si gjetje kryesore të monitorimit mund të përmendim se:

- Bashkia Tiranë përgjithësisht është angazhuar me seriozitet në adresimin dhe përmbushjen e të pesë pikave që përmban Deklarata "Çfarë kërkojnë të rinjtë e Tiranës?".
- Nga matja e progresit të deritanishëm, rezulton se arritjet janë të dukshme në të pestë pikat e tjera të kësaj Deklarate.

Më konkretisht rezultatet nga angazhimi i Bashkisë Tiranë në përmbushje të pesë pikave të Deklaratës, për këto tre vite, paraqiten në tabelën në vijim:

NR	PIKAT/ÇËSHTJET	SYNIMI/TARGET	ARRITJA/REALIZIMI
1	Të trefishohet buxheti për rininë.	Të trefishohen shpenzimet për rininë nga 1% në 3%, ku të përfshihet dhe mbështetja për organizatat e shoqërisë civile për të rejat dhe të rinjtë.	- Të dhënat e vëna në dispozicion nga Bashkia Tiranë për monitorimin e kësaj pike, janë të mjaftueshme për të arritur në shifra konkrete krahasuese për tre vitet e monitoruara. Buxheti i Rinisë në vitin 2016 ka qenë 5,000,000 ALL, në vitin 2017 u bë 10,000,000 ALL dhe në vitin 2018 u bë 15,000,000 ALL. I njëjti buxhet është edhe për vitin 2019. Pra buxheti është trefishuar.

[3] Një kopje të Deklaratës së nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Tiranë mund ta gjeni bashkëlidhur këtij raporti si shtojcë 1.

2.	Të nxitet sipërmarrja rinore.	- Patentimi i ideve apo mbrojtja e bizneseve dhe sipërmarrjes rinore përmes skemës mbrojtëse të patentimit (copyright). - Organizimi i konkurseve «Ide inovative», me qëllim nxitjen e punësimit të të rejave dhe të rinjve dhe sipërmarrjeve rinore, në bashkëpunim me pushtetin vendor.	- Nuk janë ndërmarrë veprime për ngritjen e skemës mbrojtëse të patentimit. - Përzgjedhja e të rejave dhe të rinjve që kanë përfituar grante për nxitjen e sipërmarrjeve si dhe e atyre që po kryejnë praktikën e punës pranë Bashkisë Tiranë, është bërë pikërisht përmes konkurseve për "Ide inovative". Gjithashtu Bashkia Tiranë ka realizuar programet e Start Up dhe "Të rinj dhe të reja drejt një profesioni".
3.	Të hapen Qendra Rinore në zonat periferike.	- Të hapen minimalisht dy Qendra Rinore në zonat periferike të Tiranës, ku të rejat dhe të rinjtë, sidomos ato/ata nga grupe të margjinalizuara apo me nevoja të veçanta dhe që nuk kanë akses në aktivitete kulturore e sportive, të kenë mundësinë të përfshihen, organizojnë aktivitete dhe argëtohen në një qendër të kompletuar dhe të arritshme në distancë, pa kosto dhe pa qenë e nevojshme të vijnë në qendër të qytetit.	- Të gjitha bibliotekat janë kthyer në qendra multifunksionale me vendim të Këshillit Bashkiak me nr. 35 dt 29.03.2018. Katër biblioteka lagjesh janë rikonstruktuar plotësisht dhe janë kthyer në Qendra multi-funksionale, duke filluar nga dhjetori 2017, si: Hamit Beqaj, Musine Kokalari, Petro Zheji dhe Misto Treska. - Vëmendje dhe prioritet u jepet aktiviteteve të propozuara nga vetë të rejat dhe të rinjtë. - Së shpejti kalendari i aktiviteteve që zhvillohen në këto qendra do jetë në dispozicion on-line. - Aktualisht kanë filluar punimet në bibliotekën e Njësisë nr 6 dhe 11 dhe në vijim do të fillojnë punimet në bibliotekën e Njësisë nr 2.
4.	Të nxirret dhe fillojë të funksionojë Karta e të Rinjve dhe Studentit.	Karta e të Rinjve dhe Studentit të jetë funksionale sipas parashikimeve edhe në Planin Kombëtar të Veprimit për Rininë (PKVR) 2015-2020.	- Studentët e universiteteve të Tiranës prej datës 27 Maj 2019 janë pajisur me kartën studentore, falë së cilës përfitojnë shërbime falas ose me kosto të reduktuar. - Karta lëshohet pa pagesë, vlefshmëria e saj përkon me kohëzgjatjen e studimeve, përmban nr. matrikullimi, ka një barcode të caktuar dhe ka akses në të gjitha institucionet apo subjekte, të cilat në ambjentet e tyre kanë të afishuara stikerat me logon karta e studentit.

			- Përveç platformës të ngritur on line kartaestudentit.al tanimë Aplikacioni Karta e Studentit shkarkohet si në Android ashtu edhe IOS. Aplikacioni është praktik, i shpejtë dhe i jep mundësi studentit të njihet jo vetëm me shërbimet që ofrohen me çmime të reduktuara përmes kartës së studentit por edhe të njoftohet në kohë reale për promocione apo aktivitete të ndryshme, të cilët organizohen në Bashkinë Tiranë.
5.	Të krijohet Bordi Rinor Këshillimor i Bashkisë Tiranë.	Krijimi i Bordit Rinor Këshillimor në Bashkinë Tiranë brenda vitit 2016, si një strukturë këshilluese nga të rejat dhe të rinjtë në të gjitha fazat e vendimmarrjes, hartimit dhe monitorimit të politikave rinore.	- Bordi Rinor Këshillimor i krijuar në tetor 2015 dhe funksional që nga viti 2016. - Struktura, përbërja, anëtarësimi, funksionet, etj., janë strukturuar në rregulloren e funksionimit të tij, e cila është në proces përfundimi. - Bordi Rinor Këshillimor jep kontribut të rëndësishëm këshillues në çështjet e rinisë dhe ka qenë mjaft aktiv gjatë përgatitjes së Planit Lokal të Veprimit për të Rinjtë (PLVR) 2018-2020.

Bazuar në sa më sipër, për të ardhmen do të sugjeronim:

- Të rritet transparenca dhe llogaridhënia e Bashkisë Tiranë kundrejt qytetareve e qyetarëve dhe sidomos kundrejt të rejave e të rinjve, përmes publikimit në faqen e internetit të një tabele të thjeshtë e të kuptueshme me të dhënat mbi buxhetin e planifikuar dhe të shpenzuar për rininë, në tre vitet e fundit. Kjo tabelë duhet të përmbajë informacion të plotë për të gjitha projektet dhe iniciativat e realizuara dhe jo të paraqesë të dhëna në grup (p.sh. thjesht Buxheti i Drejtorisë së Rinisë). Shpenzimet administrative duhet të ndahen nga shpenzimet që lidhen me adresimin drejtpërsëdrejti të prioriteteve të rinisë.

- Të vihen në funksionim mekanizma monitorimi e vlerësimi që të mund të matet impakti dhe kosto-efektiviteti i të gjitha iniciativave të deritanishme të ndërmarra në drejtim të: nxitjes së sipërmarrjes rinore, punësimit dhe aftësimit të të rejave e të rinjve, si dhe për formimin profesional dhe nxitjen e ideve krijuese të tyre. Po kështu është mirë të monitorohet dhe vlerësohet impakti i aktiviteteve të realizuara në bibliotekat – qendra rinore multi-funksionale, si dhe të monitorohet se sa dhe si merren në konsideratë shqetësimet e përcjella në bashki nga të rejat dhe të rinjtë

përmes Bordit Rinor Këshillimor. Efektiviteti i këtij të fundit duhet të rritet përmes vënies në funksionim të rregullores dhe marrjes së masave që, në anëtarësi, të ruhet balanca gjinore, etnike, e grupeve të pafavorizuara, etj.

- Të krijohen mekanizmat përkatës monitorues të impaktit që do të ketë përdorimi i kartës rinore.

1. HYRJE DHE PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM

1.1. DEKLARATA "ÇFARË KËRKOJNË TË RINJTË E TIRANËS?"

Deklarata "Çfarë kërkojnë të rinjtë e Tiranës?" është një dokument i përgatitur nga Rrjeti i Organizatave "Zëri i të Rinjve" (Rrjeti), i cili koordinohet nga Observatori dhe mbështetet nga UNFPA Shqipëri.

Rrjeti "Zëri i të Rinjve" përbëhet nga 19 organizata dhe 2 klube rinore, të specializuara për të punuar me grupe të ndryshme të të rejave dhe të rinjve në Shqipëri. Rrjeti është krijuar si një strukturë joformale që në korrik 2015, në kuadër të fushatës rajonale "Zëri i të rinjve" që u lançua nga zyrat rajonale të UNFPA-së në tetor të vitit 2014, në mbështetje të fushatës globale për përfshirjen e nevojave dhe rekomandimeve të të rejave dhe të rinjve në axhendën e re të zhvillimit përtej 2015 dhe në mënyrë të veçantë, në Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG).

Deklarata "Çfarë kërkojnë të rinjtë e Tiranës?" u përgatit në kuadër të aktiviteteve të Rrjetit "Zëri i të Rinjve" dhe u nënshkrua nga Kryetari i Bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj, në 9 nëntor 2015. Çështjet e parashtruara në të ishin diskutuar paraprakisht në takimet konsultuese të Rrjetit me të rejat dhe të rinjtë e Tiranës dhe bazoheshin edhe në prioritetet për rininë të premtuar nga z. Veliaj në planin e tij katër vjeçar qeverisës, si dhe në Planin Kombëtar të Veprimit për Rininë (PKVR) 2015-2020[4].

Pesë kërkesat kryesore në këtë Deklaratë ishin:

1. Të trefishohej buxheti i Bashkisë Tiranë i alokuar për rininë (nga 1% në 3%)
2. Të ngrihej një instrument publik transparent që tregon iniciativat dhe sipërmarrjet rinore të mbështetura nga bashkia
3. Të hapeshin të paktën dy Qendra Rinore në zonat periferike të Tiranës
4. Të vihej në fuqi Karta e të Rinjve dhe Studentit
5. Të krijohej Bordi Rinor Këshillimor i Bashkisë Tiranë.

Në Deklaratë saktësohej gjithashtu se me të reja dhe të rinj nënkuptohej grupi moshor 15-29 vjeç, që në vitin e nënshkrimit të Deklaratës përbënte dhe 24% të popullsisë, sipas të dhënave të janarit të atij viti, të Institutit të Statistikave (INSTAT).

Në kuadër të plotësimit të pesë kërkesave të cituara më sipër, në Deklaratë u theksuan edhe katër parime të rëndësishme që duhet të ndiqeshin përgjatë gjithë periudhës kohore 2015-2018, të tilla si:

- Përfshirja qartësisht e pesë pikave në planet e zhvillimit të bashkisë.
- Vendosja e një mekanizmi komunikimi dhe informimi të vazhdueshëm dhe transparent, si një element kyç për një proces efektiv dhe bilateral ndërmjet Bashkisë dhe komunitetit të të rejave e të rinjve të Tiranës, që do të mundësonte pjesëmarrjen e tyre, transparencë dhe llogaridhënie.
- Pjesëmarrja e qenësishme e të rejave dhe të rinjve në hartimin, buxhetimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave dhe programeve që ndikojnë në jetën e tyre.

[4] Miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 383 datë 06.05.2015

- Akses i plotë në proces si një element thelbësor për plotësimin e pesë kërkesave.

Pas nënshkrimit të Deklaratës, Observatori përgatiti dhe një Plan Monitorimi ku u përcaktua si periudhë monitorimi tetor 2018 – shtator 2019. Në këtë plan monitorimi u bë edhe një përshkrim i të dhënave bazë në momentin e nënshkrimit të Deklaratës (baseline), u përcaktuan synimet për secilën nga pesë pikat e kërkuara (target) si dhe u specifikuan mjetet e monitorimit dhe disa nga pyetjet monitoruese. Gjatë përgatitjes së metodologjisë së monitorimit të përdorur për mbledhjen e të dhënave, si dhe për përgatitjen e këtij raporti monitorimi, u mbajt në konsideratë edhe Plani i Monitorimit i vitit 2015. Një pjesë e mirë e të dhënave u mblodhën pikërisht duke u dhënë përgjigje pyetjeve monitoruese të përcaktuara në atë Plan Monitorimi[5].

1.2. PËRSHKRIM I SITUATËS NË MOMENTIN E NËNSHKRIMIT TË DEKLARATËS

Gjatë procesit të përgatitjes së Deklaratës për t'iu paraqitur Kryetarit të Bashkisë Tiranë për nënshkrim, Observatori mblodhi të dhënat bazë në lidhje me situatën mbi të pesë pikat që u propozuan për t'u ndërmarrë si angazhime për plotësim nga Bashkia. Përshkrimi i situatës në momentin e nënshkrimit të Deklaratës, bazohet pikërisht në këto të dhëna të mbledhura në vitin 2015. Duhet theksuar që, me përjashtim të kërkesës në pikën e parë të Deklaratës, të gjitha pikat e tjera lidhen dhe reflektojnë ngushtësisht edhe veprimet e parashikuara në PKVR 2015-2020, siç shpjegohen në vijim:

a) Buxheti për rininë. Buxheti për rininë në Planin Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2013-2015 të Bashkisë Tiranë përllogaritej vetëm nëpërmjet programit "Zhvillimi i rinisë dhe sportit". Totali i shpenzimeve të Bashkisë së Tiranës (korente dhe kapitale) në lekë, për këtë program nga viti 2013 në vitin 2015 kishte pësuar rënie, praktikisht nga 110,753 Lekë në vitin 2013 në 80,068 Lekë në vitin 2015. Shpenzimet për këtë program përbënin vetëm 1% të totalit të shpenzimeve të Bashkisë Tiranë për vitin 2015. Ndërsa nga pikëpamja e organikës, Sektori i Rinisë ishte një sektor nën varësinë e Drejtorisë së Rinisë dhe Sporteve. Sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 14 datë 02.05.2012 "Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së aparatit të Bashkisë së Tiranës", misioni i Sektorit të Rinisë ishte hartimi i politikave dhe planeve të veprimit duke synuar intensifikimin e jetës rinore dhe zhvillimin e infrastrukturës së ambjenteve rinore me parametra bashkëkohorë. Ky mision duhet të përmbushej përmes një sërë detyrash dhe përgjegjësish, të cilat, nisur nga rënia e shpenzimeve të programit "Zhvillimi i rinisë dhe sportit", nuk mund të themi se janë plotësuar. Plotësimi i këtij misioni është dhe një nga dhjetë pikat e programit të qeverisjes së Kryetarit aktual të Bashkisë, z. Veliaj.

b) Nxitja e sipërmarrjes rinore. Nxitja e sipërmarrjes së të rejave dhe të rinjve përballej me shumë kufizime si: mungesa e burimeve financiare (niveli i ulët i kapitalit fillestar), mungesa e ambienteve të përshtatshme për zhvillimin e një biznesi, numri i vogël i llojshmërisë së biznesit, mungesa e njohurive dhe aftësive të duhura për të hapur një biznes, mungesa e lehtësirave për këtë kategori, etj. Deri në vitin 2015 nuk ka pasur një informacion të qartë në lidhje me strategjinë për partneritetin e Bashkisë Tiranë me bizneset për nxitjen e sipërmarrjeve rinore. Megjithatë, në PKVR 2015-2020, objektivi strategjik 2 fokusohet pikërisht tek nxitja e punësimit të të rejave dhe të rinjve përmes politikave efektive të tregut

[5] Një version të plotë të Planit të Monitorimit të përgatitur në vitin 2015, mund ta gjeni bashkëlidhur këtij raporti monitorimi si shtojcë 2.

të punës. Disa nga objektivat specifike të parashikuara për arritjen e këtij objektivi strategjik kanë të bëjnë me: përmirësimin e kuadrit ligjor për nxitjen e programeve të sipërmarrjes rinore, rritjen e kualifikimit profesional dhe menaxherial të të rejave dhe të rinjve, si dhe promovimin dhe fuqizimin e programeve të nxitjes së punësimit rinor. Ndër veprimet konkrete të parashikuara për t'u zbatuar në bashkëpunim me pushtetin vendor janë: organizimi i konkurseve rajonale «Ide inovative» me qëllim nxitjen e sipërmarrjeve rinore, të shoqëruara me mekanizma nxitës dhe mbështetës[6], zgjerimi i gamës së kurseve të ofruara nga Agjensitë e Formimit Profesional, sipas kërkesës së tregut të punës dhe traditës apo nevojave specifike të zonave të ndryshme[7], fushata ndërgjegjësimi për nxitjen e të rejave dhe të rinjve të ndjekin kurse profesionale të lidhura me traditën dhe nevojat e zonave[8], si dhe mbështetja e aktiviteteve artizanale që nxisin vetë-punësimin e grave të reja nga zonat rurale[9]. Patentimi i ideve dhe mbrojtja e bizneseve apo sipërmarrjes rinore përmes skemës mbrojtëse të patentimit (copyright) është një tjetër ide e parashikuar në PKVR 2015-2020.

c) Hapja e Qendrave Rinore në zonat periferike të Tiranës. Objektivi strategjik 1 i PKVR 2015-2020 fokusohet në nxitjen dhe pjesëmarrjen e të rejave dhe të rinjve në proceset/vendimarrjet demokratike. Disa nga objektivat specifike të parashikuara për arritjen e këtij objektivi strategjik kanë të bëjnë me: forcimin e strukturave dhe kapaciteteve të organizatave rinore, rritjen e përfaqësimit të të rejave dhe të rinjve në proceset vendimmarrëse dhe strukturat e qeverisjes vendore, ndërgjegjësimin dhe edukimin e të rejave dhe të rinjve për pjesëmarjen në procesin zgjedhor, si dhe fuqizimin e mbështetjes për të rejat, të rinjtë dhe organizatat rinore. Një ndër veprimet kryesore të parashikuara për të filluar zbatimin e objektivit strategjik 1, fokusohet ndër të tjera në ngritjen e Qendrave Rajonale Rinore (12 qendra në total), të cilat do të jenë njësi të drejtpërdrejta për organizimin e aktiviteteve dhe shërbimeve për të rejat dhe të rinjtë[10]. Në Mars të vitit 2015, Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë (MMSR) - aktualisht Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) - inaguroi qendrën e parë Rinore në Tiranë, e cila është nën varësinë e Shërbimit Kombëtar për Rininë. Ndërkaq në programin e Kryetarit të Bashkisë Tiranë z. Veliaj, flitet për hapjen e 6 (gjashtë) Qendrave Rinore në Bashkinë e Tiranës. Është e rëndësishme që të ketë një përshkrim të qartë të këtyre qendrave dhe të bëhet dallimi në shërbimet që ofrojnë ato krahasuar me Qendrat Rajonale Rinore. Do të ishte mirë që Qendrat Rinore në Bashkinë e Tiranës të fokusoheshin kryesisht tek nevojat dhe kërkesat e të rejave dhe të rinjve që jetojnë në zonat periferike të Tiranës, apo që u përkasin grupeve të pafavorizuara si p.sh. të reja dhe të rinj me aftësi të kufizuara, të reja dhe të rinj nga minoritetet etnike, etj. Gjithashtu, do të ishte me interes që këto qendra të hapeshin pranë vendbanimit të të rejave dhe të rinjve nga grupe apo komunitete të pafavorizuara, me qëllim që ato/ata të kenë mundësi të frekuentojnë aktivitetet e qendrave pa kosto dhe pa pasur nevojë të udhëtojnë për të ardhur dhe për të pasur akses në shërbimet që ofron Qendra Rajonale Rinore, gjeografikisht e pozicionuar në qendër të qytetit të Tiranës.

d) Vënia në funksionim e Kartës së të Rinjve dhe Studentit. Pajisja e studenteve dhe studentëve të Tiranës me Kartën Bashkiake të Studentit ka qenë objektiv strategjik i

[6] Objektivi specifik 2.2, aktiviteti 2.2.5
[7] Objektivi specifik 2.2, aktiviteti 2.2.6
[8] Objektivi specifik 2.2, aktiviteti 2.2.7
[9] Objektivi specifik 2.3, aktiviteti 2.3.4
[10] Objektivi specifik 1.1 aktiviteti 1.1.1

Bashkisë Tiranë që përpara zgjedhjeve vendore të vitit 2015. Karta Bashkiake e Studentit u përcaktua gjithashtu si një nga objektivat kryesore të punës së Kryetarit aktual të Bashkisë Tiranë, z. Veliaj, renditur si pjesë e planit katër-vjeçar të qeverisjes së tij. Gjithashtu, në objektivin strategjik 2 "Nxitja e punësimit të të rinjve përmes politikave efektive të tregut të punës", të PKVR 2015-2020, objektivi specifik 2.6 dhe aktiviteti 2.6.1 kanë të bëjnë pikërisht me përgatitjen e Kartës Rinore dhe ekuivalentimin me Kartën Evropiane për Rininë. Në vendet evropiane kjo kartë parashikon një gamë shërbimesh lehtësuese për të rejat dhe të rinjtë të cilat/cilët e zotërojnë atë. Meqenëse si në nivel qendror dhe në nivel vendor flitej për përmbushje të këtij angazhimi brenda vitit 2016 (angazhim në fakt i pa përmbushur ende) është e rëndësishme të përcaktohet qartësisht nëse ka dallim ndërmjet dy kartave apo flitet për të njëjtën kartë, si dhe cilat do të jenë funksionet lehtësuese të saj (apo të tyre, nëse flitet për dy karta të ndryshme).

e) Krijimi i Bordit Rinor Këshillimor në Bashkinë Tiranë. Objektivi specifik 1.2 "Rritja e përfaqësimit të të rinjve në proceset vendimmarëse dhe strukturat e qeverisjes vendore" i PKVR 2015-2020, në aktivitetin 1.2.2. thekson pikërisht krijimin e Bordit Rinor Këshillimor në MMSR (aktualisht MSHMS) dhe strukturat e qeverisjes vendore (Këshillat Bashkiakë) si një strukturë këshilluese nga të rejat dhe të rinjtë në të gjitha fazat e vendimmarrjes, hartimit dhe monitorimit të politikave rinore. Krijimi i këtyre strukturave si në nivel qendror (pranë MMSR-së) edhe në nivel vendor (pranë Këshillave Bashkiakë) planifikohet të kryhet brenda viteve 2015-2016. Është e rëndësishme të përcaktohen kritere të qarta të përzgjedhjes së anëtarësisë së Bordit Rinor Këshillimor në Bashkinë Tiranë, si dhe një rregullore e funksionimit bazuar në detyrimet, përgjegjësitë dhe funksionet e kësaj strukture këshilluese.

2. METODOLOGJIA DHE PROCESI I MONITORIMIT

Metodologjia e monitorimit të zbatimit të angazhimeve të ndërmarra nga Bashkia Tiranë përmes nënshkrimit të Deklaratës, iu përshtat realizimit të një ***monitorimi të procesit*** (apo siç njihet ndryshe edhe ***monitorim i progresit fizik***) që përcakton progresin në zbatimin e angazhimeve krahasuar me rezultatet e synuara (apo target të përcaktuar). Ky lloj monitorimi u mendua si më i përshtatshëm nisur edhe nga përcaktimet në Planin e Monitorimit të përgatitur nga Observatori në momentin e nëshkrimit të Deklaratës (nëntor 2015), ku treguesit e parashikuar ishin *tregues procesi.*

Të dhënat mbi monitorimin u mblodhën nga Observatori përgjatë periudhës kohore tetor 2018 – shtator 2019. Një pjesë e mirë e informacionit të nevojshëm për procesin e monitorimit u nxor nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Bashkia Tiranë. Të dhënat e mbledhura u plotësuan dhe përditësuan më tej. Të dhënat e mbledhura në terren janë të natyrës cilësore dhe mjetet e monitorimit të përdorura për këtë qëllim ishin kryesisht intervistat e thelluara. Vlen të theksohet se, informacion cilësor më i thelluar është mbledhur në lidhje me përmbushjen e dy prej pesë angazhimeve të ndërmarra nga Bashkia Tiranë me nënshkrimin e Deklaratës, konkretisht lidhur me "Nxitjen e sipërmarrjes rinore" dhe "Krijimin e Bordit Rinor Këshillimor". Për këtë arsye u zhvilluan 10 (dhjetë) intervista të thelluara me të reja dhe të rinj të cilat/cilët kanë përfituar mbështetje nga Bashkia Tiranë në kuadër të nxitjes së sipërmarrjeve rinore, punësimit dhe praktikës profesionale, si dhe 2 (dy) intervista të thelluara me të rinj anëtarë të Bordit Këshillimor Rinor, të ngritur pranë Bashkisë Tiranë.

Për mbledhjen e informacionit të përgjithshëm lidhur me progresin për përmbushjen e angazhimeve të Deklaratës u përdorën kryesisht pyetjet monitoruese të përcaktuara në Planin e Monitorimit. Po kështu edhe në strukturën e intervistave të thelluara për mbledhjen e informacionit cilësor u përdorën nga këto pyetje si edhe pyetje të tjera për të marrë informacionin e kërkuar. Disa nga pyetjet kryesore monitoruese ishin[11]:

- Cili është buxheti i alokuar për rininë në Bashkinë e Tiranës në vitet 2016 - 2017 - 2018?
- Cila është strategjia e Bashkisë së Tiranës për partneritetin dhe bashkëpunimin me bizneset për nxitjen e sipërmarrjes rinore?
- A janë hapur Qendra Rinore në zonat periferike të Tiranës?
- A e ka nxjerrë Bashkia e Tiranës Kartën e të Rinjve dhe Studentit?
- A është krijuar Bordi Rinor Këshillimor në Bashkinë Tiranë dhe mbi cilat kritere përzgjedhjeje? etj.

3. REZULTATET

Në këtë seksion të raportit paraqiten gjetjet nga procesi i monitorimit, bazuar në të gjitha të dhënat e mbledhura sipas metodologjisë së përshkruar më sipër. Ai është organizuar në tre nënseksione:

- nënseksioni i parë përmban një informacion mbi përpjekjet e përgjithshme të bëra nga bashkia për adresimin e angazhimeve të ndërmarra.
- dy nënseksionet e tjera përmbajnë analizën e arritjeve të Bashkisë Tiranë në adresimin e pikës së dytë dhe të pestë të Deklaratës.

3.1. PËRPJEKJET E PËRGJITHSHME TË BASHKISË NË ADRESIMIN E ANGAZHIMEVE TË NDËRMARRA

Bashkia e Tiranës që nga momenti i nënshkrimit të Deklaratës ka ndërmarrë një sërë hapash me qëllim përmbushjen e angazhimeve të kërkuara. Kështu për periudhën kohore 2015-2018 rezulton se përgjithësisht ka pasur zhvillime pozitive në drejtim të përmbushjes së pikave të Deklaratës, ndonëse jo në të gjitha rastet progresi është i dukshëm. Nga analiza e të dhënave të mbledhura gjatë procesit të monitorimit rezulton se:

Të dhënat e vëna në dispozicion nga Bashkia Tiranë për monitorimin e kësaj pike, janë të mjaftueshme për të arritur në shifra konkrete krahasuese për tre vitet e monitoruara. Buxheti i Rinisë në vitin 2016 ka qenë 5,000,000 ALL, në vitin 2017 u bë 10,000,000 ALL dhe në vitin 2018 u bë 15,000,000 ALL. I njëjti buxhet është edhe për vitin 2019. Pra buxheti është trefishuar.

Bashkia ka hedhur hapa pozitivë në drejtim të përmbushjes së pikës së tretë të Deklaratës, pra në lidhje me hapjen e Qendrave Rinore, ndonëse hapja e tyre në zonat periferike të qytetit është përcakuar si prioritet në buxhetin e vitit 2019. Të gjitha bibliotekat janë kthyer në qendra multifunksionale me vendim të Këshillit Bashkiak me nr. 35 dt 29.03.2018. Katër biblioteka lagjesh janë rikonstruktuar plotësisht dhe janë kthyer në Qendra multi-funksionale, duke filluar nga dhjetori 2017, si: Hamit Beqaj, Musine Kokalari, Petro Zheji dhe

[11] Më shumë informacion mbi pyetjet monitoruese apo strukturën e intervistave të thelluara mund të gjeni në shtojcat 2 dhe 3 të këtij raporti.

Misto Treska. Aktualisht kanë filluar punimet në bibliotekën e Njësisë nr 6 dhe 11 dhe në vijim do të fillojnë punimet në bibliotekën e Njësisë nr 2. Akivitetet e zhvilluara deri tani duket se kanë ngjallur interes dhe kanë ndikuar në nxitjen e iniciativave të të rejave dhe të rinjve. Megjithatë, është e rëndësishme që të përfundojë sa më parë aplikacioni që do të shërbejë për publikimin on-line të kalendarit të aktiviteteve në këto qendra. Me rivitalizimin dhe vënien në funksionim edhe të gjithë bibliotekave, si dhe me vënien në funksionim të aplikimit on-line për publikimin e kalendarit të aktiviteteve që duhet të bazohen në interesat dhe prioritetet e të rejave dhe të rinjve, si dhe që duhet të aktivizojnë maksimalisht grupet më të pafavarizuara, ky angazhim do të mund të konsiderohet i përmbushur plotësisisht.

Përsa i takon pikës së katërt të Deklaratës, pra në lidhje me aplikimin e Kartës së të Rinjve dhe Studentit, Bashkia Tiranw qw prej datws 27 maj 2019, ka pajisur **studentët e universiteteve të Tiranës me kartën studentore**, falë së cilës përfitojnë shërbime falas ose me kosto të reduktuar. Karta lëshohet pa pagesë, vlefshmëria e saj përkon me kohëzgjatjen e studimeve, përmban nr. matrikullimi, ka një barcode të caktuar dhe ka akses në të gjitha institucionet apo subjekte, të cilat në ambjentet e tyre kanë të afishuara stikerat me logon *karta e studentit.* Përveç platformës të ngritur on line *www.kartaestudentit.al* tanimë *Aplikacioni Karta e Studentit* shkarkohet si në Android ashtu edhe IOS. Aplikacioni është praktik, i shpejtë dhe i jep mundësi studentit të njihet jo vetëm me shërbimet që ofrohen me çmime të reduktuara përmes kartës së studentit por edhe të njoftohet në kohë reale për promocione apo aktivitete të ndryshme, të cilët organizohen në qytetin tonë.
Çdo shërbim i ofruar gjendet në hartën e aplikacionit bashkë me adresën dhe informacione të tjera të nevojshme të çdo institucioni publik apo privat, të cilët tanimë janë partnerët më të mirë të studentëve të Tiranës.
Shërbime të ndryshme publike dhe private që ofrohen në Tiranë:

- ✓ Sektori bankar (zbritje në komisione, llogari rrjedhëse, etj)
- ✓ Sektori shëndetësor (laborator analizash, klinika dentare, etj.)
- ✓ Sektori i artit, kulturës dhe turizmit
- ✓ Edukim joformal
- ✓ Librari
- ✓ Sport dhe rekreacion (fitness)
- ✓ Ushqim
- ✓ Veshje dhe këpucë
- ✓ Estetikë
- ✓ Telefoni dhe shërbime të tjera në lidhje me të
- ✓ Bar-Kafe

Bashkia e Tiranës, përveç subjekteve që janë në varësi të saj, si Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, Tirana Olimpik Park, bibliotekat e lagjeve, Shtëpia Studio Kadare, Kulla e Sahatit, Teatri Metropol apo shërbime të tjera të ofruara falas ose me zbritje, ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi me subjekte të tjera private të cilat ofrojnë zbritje të ndryshme për të gjithë kartëmbajtësit.

Në mënyrë më të detajuar, rezultatet në përmbushjen e këtyre tre pikave të Deklaratës për periudhën 2015-2018, mund të formulohen si në vijim:

- ***Bashkia Tiranë i ka intensifikuar përpjekjet e saj*** për të adresuar sa më mirë çështjet e të rejave dhe të rinjve të Tiranës.

- Sipas organigramës së Bashkisë[12], ***përgjegjësinë për trajtimin e çështjeve të rinisë tashmë e ka Drejtoria e Rinisë, një strukturë më vehte nën Drejtorinë e Përgjithshme të Promovimit të Qytetit***. Në bazë të rregullores në fuqi të datës 17.02.2017, Drejtoria e Rinisë është përgjegjëse për zbatimin e strategjive, politikave dhe planeve të rinisë në të gjithë territorin e Bashkisë, si dhe për sektorët në varësi, programet, veprimtaritë dhe proceset që menaxhohen prej saj, në përputhje me parimet e ligjshmërisë dhe të transparencës. Avancimi nga Sektor i Rinisë nën Drejtorinë e Rinisë dhe Sporteve që ishte në vitin 2015 në Drejtori të Rinisë nën Drejtorinë e Përgjithshme të Promovimit të Qytetit, sigurisht që shënon progres. Natyrshëm edhe buxheti i Bashkisë Tiranë i planifikuar dhe sidomos i shpenzuar për adresimin e çështjeve të rinisë ka pësuar rritje, krahasuar me buxhetin e shpenzuar deri në vitin 2015, duke u trefishuar.

- ***Bashkia e Tiranës ka miratuar dhe po zbaton në rreth 40 shkolla nëntë-vjeçare dhe të mesme Projektin "Shkolla Qendër Komunitare".*** Sipas këtij projekti lejohet shfrytëzimi i palestrave dhe ambjenteve sportive të këtyre shkollave (të rikonstruktuara nga Bashkia Tiranë) nga Federatat sportive/Shoqatat sportive/Klubet sportive pas orarit të rregullt mësimor dhe gjatë ditëve të pushimit, për edukimin dhe masivizimin e shumëllojshmërisë së sporteve në Tiranë. Ky projekt synon formimin e fëmijëve dhe të rejave e të rinjve në aspektin fizik dhe mendor, si mjet për të luftuar sedentarizmin dhe për të shmangur çdo formë të shfaqjeve negative mënyrës së shfrytëzimit të kohës, apo obezitetin. Gjithashtu projekti ndikon dhe në zhvillimin e miqësive ndërmjet nxënëseve dhe nxënësve, të rejave dhe të rinjve, duke u përfshirë në aktivitete sportive. Federatat sportive/Shoqatat sportive/Klubet sportive duhet të mbështesin integrimin në aktivitete sportive pa pagesë të fëmijëve, të rejave dhe të rinjve të cilat/cilët vijnë nga grupe sociale vulnerabël (familje në nevojë, jetimë, familje që trajtohen me ndihmë ekonomike etj.). Po kështu Federatat sportive/Shoqatat sportive/Klubet sportive angazhohen që dy ditë në javë të ofrojnë aktivitete sportive pa pagesë në shërbim të komunitetit. Me qëllim që të mbulohen shpenzimet e ndryshme që realizohen gjatë zbatimit të projektit si psh. energji elektrike dhe ujë, Federata sportive/Shoqata sportive/Klubi sportiv detyrohet të paguajë shumën prej 150 lekë çdo orë. Ndërkohë që pastrimin e ambjenteve duhet ta bëjë vetë Federata sportive/Shoqata sportive/Klubi sportiv. Në rast dëmtimi të ambjenteve në përdorim, Federata sportive/Shoqata sportive/Klubi sportiv duhet të dëmshpërblejë Bashkinë për riparimin e dëmit të shkaktuar.

- ***Katër bibliotekat e rikonstruktuara të qytetit të Tiranës të përfshira në projektin e Bashkisë "Bibliotekat e lagjeve si qendra multi-funksionale" janë të hapura dhe të aksesueshme nga të gjitha të rejat dhe të rinjtë e zonave ku këto biblioteka ndodhen***. Të rivitalizuara si Qendra Rinore dhe multi-funksionale janë bibliotekat: "Petro Zheji", "Musine Kokalari, "Misto Treska" dhe "Hamid Beqaj" (kjo e fundit ka edhe funksionin e një Biblioteke Ndërkombëtare ku çdo Ambasadë ka këndin e saj të librave). Ndërkohë aktualisht kanë filluar punimet në bibliotekën e Njësisë nr 6 (Kombinat) dhe Njësinë nr 11 (Laprakë) dhe në vijim do të fillojnë punimet në

[12] Siç paraqitet në faqen e internetit të Bashkisë Tiranë, shiko: https://www.tirana.al/struktura-organizative

bibliotekën e Njësisë nr 2 (afër Pazarit të Ri, pranë Rr. "Tefta Tashko"). Në vijim të vendimit Nr. 35, datë 29.03.2018 të Këshillit Bashkiak "Për miratimin e përdorimit të ambienteve të bibliotekave të lagjeve si qendra multi-funksionale" çdo shoqatë ka të drejtë të aplikojë për marrjen në përdorim të hapësirës së Bibliotekës. Detajet janë të publikuara në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Tiranë, e cila po punon gjithashtu edhe për krijimin e një aplikacioni për publikimin on-line të kalendarit të të gjitha aktiviteteve dhe shërbimeve që ofrohen në këto qendra. Po kështu, rëndësi i kushtohet organizimit të aktiviteteve, veçanërisht të atyre aktiviteteve të propozuara nga vetë të rejat dhe të rinjtë. Në këto raste Bashkia Tiranë ofron brenda mundësive edhe mbështetje logjistike. Aktivitetet kryesore të zhvilluara në bibliotekat qendra rinore multi-funksionale gjatë periudhës shtator – dhjetor 2018 përfshijnë por nuk kufizohen në: a) fushatën e leximit, që synon rritjen e kulturës së leximit për të rejat, të rinjtë dhe fëmijët; b) program informimi për vajzat në kuadër të projektit "Dixhitalizimi i vajzave", mbi studimet në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit; c) aktivitete që lidhen me edukimin mjedisor; d) takime me të rejat dhe të rinjtë për fuqizimin e qytetares/qytetarit aktiv dhe rolit të tyre në komunitet, etj.

- ***Bashkia e Tiranës ka nisur pajisjen e studentëve të universiteteve të Tiranës prej datës 27 Maj me kartën studentore, falë së cilës përfitojnë shërbime falas ose me kosto të reduktuar.***

3.2. ARRITJET NË LIDHJE ME "NXITJEN E SIPËRMARRJES RINORE"

Bashkia e Tiranës duke filluar nga viti 2016 ka hedhur një sërë hapash të rëndësishëm në drejtim të nxitjes së sipërmarrjes rinore. Kështu, në tetor të vitit 2016[13] u planifikua për zbatim **"Programi i Nxitjes së Punësimit në ndihmë të krijimit të Biznesit Social Rinor"**, për të rejat dhe të rinjtë që ushtronin aktivitetin e tyre në Tiranë. Programi synoi të krijojë lehtësi për ngritjen e Biznesit Social me sipërmarrës/e të rejat dhe të rinjtë, nga të gjitha kategoritë, duke u dhënë prioritet të rejave dhe të rinjve të grupmoshës 18-35 vjeç; të rejave dhe të rinjve me aftësi të kufizuara; të rejave dhe të rinjve banore/banorë të qytetit të Tiranës që ishin studente/studentë; si dhe të rejave dhe të rinjve të papunë. Kandidatet/ët dhe pjesëmarrëset/it e pranueshëm ishin të reja dhe të rinj që jetonin dhe/ose kishin një biznes shumë të vogël, ose të vogël në territorin e Bashkisë së Tiranës, në kohën e aplikimit. Aktivitetet e pranueshme për aplikim duhet të përfshiheshin në një nga sektorët: biznes rural, turizëm, teknologji e informacionit dhe komunikimit, industri tekstile, shërbimet dhe artizanati. U vlerësuan ato projekte që ishin më inovatore, fitimprurëse por edhe në përputhje me politikat e Bashkisë së Tiranës, pra që ofronin një plan-biznesi bindës dhe konkurues. Elementët kyç të programit përfshinë një *proces aplikimi të drejtë dhe konkurues, trajnim në aftësitë bazë të biznesit, përgatitje të një plani biznesi të shëndoshë dhe të zbatueshëm, mbështetje financiare (nëpërmjet ofrimit të granteve) për të filluar biznesin, si dhe udhëheqje*. ***Fondi në ndihmë të krijimit të Biznesit Social i financuar nga burime publike për vitin 2016 ishte 10,000,000 lekë***, i përllogaritur për 20 (njëzet) përfitues/e me masë financimi për individ 500,000 lekë, për secilin plan biznesi të zhvilluar me sukses, së bashku me asistencën për udhëheqje deri në dy vite pas fillimit të zbatimit të planit të biznesit. Aplikanti/Aplikantja duhet të ofronte kontribut financiar të barasvlershëm

[13] Programi i nxitjes së punësimit të biznesit rinor (I) miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr.65 datë 07.10.2016

me të paktën 20% të financimit të kërkuar me grant. Përpara vënies në zbatim të projektit të mësipërm, Bashkia e Tiranës përgatiti edhe një Udhëzues Operacional për këtë qëllim, me të gjitha të dhënat dhe formularët e domosdoshëm për t'u përdorur gjatë gjithë periudhës së financimit të projektit deri në përfundimin e tij, përfshirë këtu dhe organet zbatuese apo treguesit e monitorimit dhe vlerësimit të projektit. Nga 75 aplikime në total, u përzgjodhën fillimisht dhe u trajnuan 32 aplikante/aplikantë për idetë më të mira të biznesit dhe në përfundim të të gjithë procesit u përzgjodhën si ***përfituese/përfitues të grantit 20 aplikante/aplikantë*** me planet më të mira të biznesit. 3 (tre) e tërhoqën kërkesën e tyre nga përfitimi i grantit. Në Qendrën Kombëtare të Bizneseve *u regjistruan 11 (njëmbëdhjetë) biznese të reja,* dhe *u zgjeruan 9 (nëntë) biznese ekzistuese*. Nga këto subjekte përfituese *u punësuan rreth 20 (njëzet) persona*. Vazhdimësia e mbështetjes dhe financimit të projektit për nxitjen e krijimit të Bizneseve Sociale Rinore është konfirmuar edhe për vitin 2018[14] e në vijim, me të njëjtën logjikë dhe të njëjtat kritere siç u mbështet dhe krijimi apo zgjerimi i këtyre bizneseve përgjatë periudhës kohore 2016-2018.

Një tjetër përpjekje e Bashkisë Tiranë për të fuqizuar ekonomikisht të rejat dhe të rinjtë e papunë, nxitur dhe nga suksesi i arritur në drejtim të mbështetjes së krijimit të sipërmarrjeve rinore, është zbatimi i projektit ***"Të rinjtë dhe të rejat drejt një profesioni"***, iniciuar gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2017[15]. Projekti synoi të krijojë lehtësi për punësimin e të rejave dhe të rinjve deri në moshën 29 vjeç, rezidentë në territorin e Bashkisë Tiranë në momentin e aplikimit, të cilat/cilët kishin më pak se 36 muaj që kishin përfunduar studimet universitare brenda apo jashtë vendit dhe ishin të papunë në kërkim të një pune. Prioritet iu dha të rejave dhe të rinjve me aftësi të kufizuara, të rejave dhe të rinjve që kishin përfunduar studimet me rezultate të larta, si dhe të rejave dhe të rinjve nga familje të përfshira në skemën e ndihmës ekonomike apo nga grupe të tjera të pafavorizuara. Aplikantet/Aplikantët duhet të ofronin besueshmëri, përkushtim dhe gadishmëri pranë biznesit ku do të kryenin praktikën. Biznesi do të kryente edhe vlerësimin përfundimtar të tyre dhe në varësi të performancës gjatë praktikës do të vendoste dhe për punësimin e praktikantit apo praktikantes. ***Fondi total i projektit për vitin 2017 ishte 2,100,000 lekë***, për një total prej 15-20 përfituesesh/përfituesish planifikuar për të rimbursuar punëdhënësit për pagën minimale bruto, e cila u paguhet përfitueseve dhe përfituesve për gjithë periudhën e zhvillimit të praktikës profesionale (3-6 muaj). Bizneset e pranueshme për këtë projekt ishin nga sektorët: bankar, turizëm, teknologji e informacionit dhe komunikimit, industri, shërbime, si dhe shërbime ligjore, konsulente dhe financiare. Zbatimi i projektit u parapri nga *një fushatë ndërgjegjësuese fokusuar tek grupi i synuar, ku u sqaruan të gjitha hapat nga aplikimi deri në përzgjedhjen, kryerjen e praktikës profesionale të paguar si dhe mundësinë për punësim afatgjatë*. Kriteret e aplikimit, formularët përkatës, marrëveshjet me bizneset, treguesit e monitorimit dhe vlerësimit, organet zbatuese dhe monitoruese të projektit, si dhe të dhënat financiare u pasqyruan gjithashtu në Udhëzuesin Operacional të përgatitur nga Bashkia Tiranë për këtë projekt. 8 të rinj dhe 12 të reja filluan praktikën në vitin 2017, në përfundim të të cilës u punësuan 8 të rinj dhe 5 të reja. Bazuar në suksesin dhe rezultatet e arritura nga zbatimi i projektit, Bashkia vendosi të vijojë

[14] Programi i nxitjes së punësimit të biznesit rinor (II) miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr.108 datë 27.09.2018

[15] Projekti "Të rinjtë dhe të rejat drejt një profesioni" (I) miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr.40 datë 05.04.2017

mbështetjen e të rejave dhe të rinjve përmes kësaj iniciative edhe përtej vitit 2018[16] duke përdor të njëjtën logjikë dhe pothuajse të njëjtat kritere[17], siç u përdorën në vitin 2017.

Një tjetër iniciativë e ndërmarrë nga Bashkia Tiranë gjatë vitit 2018[18] për mbështetjen dhe fuqizimin ekonomik të të rejave dhe të rinjve është edhe projekti **"Fillo me një ide – fito një internship në Bashkinë Tiranë"**. Qëllimi i këtij projekti është t'u mundësojë të rejave dhe të rinjve të grupmoshës deri në 28 vjeç, në fillim të karrierës së tyre profesionale, të fitojnë një eksperiencë pune në Bashkinë Tiranë, duke u ofruar mundësinë për të zhvilluar aftësitë e tyre analitike dhe kërkimore përmes konkurrimit me një projekt-ide ose studim në një nga fushat e veprimtarisë së Bashkisë. Të rejat dhe të rinjtë patën mundësi të përgatisnin dhe dorëzonin një propozim të plotë teknik dhe financiar të projektit me synim përfundimin e studimit gjatë internshipit, duke bashkëpunuar nga afër me stafin e Bashkisë për një periudhe 3 (tre) mujore praktike pune. Projekti u mundëson gjithashtu studenteve dhe studentëve të fitojnë aftësi në hartimin dhe zhvillimin e projektit, realizimin e një studimi (zgjedhja e temës, strategjia e kërkimit, mbledhja e informacionit, vlerësimi i informacionit, citimi i burimeve etj.), përmirësimin e aftësive teknike (të folurit në publik, përgatitja e një prezantimi, analiza e të dhënave etj), perfeksionimin e aftësive ndërpersonale, krijimin e një rrjeti kontaktesh me profesionistë të fushës, etj. ***Projekti u ofroi mundësinë 10 të rejave dhe 6 të rinjve të zhvillojnë praktikë pune*** duke përzgjedhur *8 (tetë) projekt ide* dhe *8 (tetë) studime* pjesë e planeve vjetore të njësive organizative të Bashkisë Tiranë dhe do të zbatohen përgjatë periudhës kohore tre mujore të paktikës. ***Për secilin projekt-ide dhe studim të përzgjedhur çmimi është në vlerën 62,500 lekë bruto***, që merret vetëm nëse të rejat dhe të rinjtë e përfundojnë me sukses projektin apo studimin, gjatë periudhës së zhvillimit të praktikës pranë Bashkisë Tiranë. Gjatë zhvillimit të praktikës së punës, studenteve dhe studentëve të përzgjedhur u janë ofruar edhe një sërë trajnimesh në fushën e menaxhimit të projektit dhe kërkimit shkencor. Projekt-idetë dhe studimet duhet të lidheshin më një nga temat: infrastruktura dhe teknologjia; energjia, uji dhe mbetjet urbane; mobiliteti; qytetarët dhe stili i jetesës; smart city; mjedisi; qeverisja dhe edukimi; zhvillimi ekonomik vendor; zhvillimi urban, si dhe qeverisja vendore. ***Në tërësi buxheti dedikuar projektit: "Fillo me një ide – fito një internship në Bashkinë Tiranë" për vitin 2018 është në vlerën 2,535,000 lekë,*** pjesë e fondit për trajnim dhe zhvillim, Aparati i Bashkisë, në programin Planifikim, Menaxhim, Administrim, të parashikuar në Buxhetin e Bashkisë Tiranë për vitin 2018. Ky projekt zbatohet gjithashtu bazuar në Udhëzuesin Operacional të përgatitur nga Bashkia Tiranë për këtë qëllim.

Në kuadër të procesit të monitorimit të përmbushjes së angazhimeve të Deklaratës së nënshkruar nga Bashkia Tiranë, pikërisht në lidhje me këtë pikë të Deklaratës ("Nxitja e Sipërmarrjes Rinore") Observatori realizoi edhe **10 (dhjetë) intervista të thelluara** me pesë të reja dhe pesë të rinj, të grupmoshës 20-29 vjeçare, të cilat/cilët kanë përfituar nga të tre projektet e sipërpërmendura. 90% e të intervistuar/ave (n=9) ishin beqar/e dhe 10% (n=1) të martuar/a. 70% (n=7) jetonin me prindërit, 20% (n=2) jetonin vetëm dhe 10% (n=1) me të tjerë. 50% (n=5) ishin me arsim pasuniversitar, 30% (n=3) ishin me arsim të lartë dhe 20%

[16] Projekti "Të rinjtë dhe të rejat drejt një profesioni" (II) miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr.107 datë 27.09.2018

[17] Një ndryshim ka të bëjë më afatin e përfundimit të studimeve, pra aplikanti/ja nuk duhet të ketë më shumë se 24 muaj që ka përfunduar studimet (nga 36 muaj që ishte në projektin e parë)

[18] Projekti "*Fillo me një ide fito një Internship"* miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 29 datë 29.03.2018

(n=2) ishin me arsim të mesëm. 40% (n=4) ishin të punësuar/a me kohë të plotë, 30% (n=3) ishin student/e, 20% (n=2) ishin të vetëpunësuar/a dhe 10% (n=1) të punësuar/a me kohë të pjesshme. Asnjë prej të intervistuar/ave nuk i përkiste ndonjë minoriteti etnik apo grupi të pafavorizuar. 30% (n=3) e tyre kishin përfituar grant në kuadër të projektit "Nxitja e Sipërmarrjes Rinore" (një e re dhe dy të rinj), 30% (n=3) kishin përfituar nga projekti "Të rinjtë dhe të rejat drejt një profesioni" (një e re dhe dy të rinj) dhe 40% (n=4) ishin duke përfituar nga projekti "Fillo me një ide fito një internship" (tre të reja dhe një i ri).

- 90% e të intervistuar/ave (n=9) mendonin se programet e Bashkisë Tiranë në mbështetje të rinisë ishin të mjaftueshme dhe 10% (n=1) që ishin të kufizuara;
- 30% e të intervistuar/ave (n=3) që kishin përfituar grant në kuadër të projektit "Nxitja e Sipërmarrjes Rinore", ishin të kënaqur/a me mbështetjen e ofruar, nuk kishin pasur probleme me strukturat tatimore apo ligjore, kanë filluar të kenë fitim nga biznesi, kanë bashkëpunim me një numër nga 3 (tre) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) biznese të tjera, dy prej tyre kanë punësuar edhe një deri dy persona të tjerë në biznesin që kanë hapur dhe grantin e dhënë nga bashkia e kanë përdorur për blerje të pajisjeve, mallrave e furnizimeve. Dy prej tyre janë shprehur se bashkia duhet të japë më shumë informacion për këtë lloj projekti dhe për mbështetjen që ofrohet, e cila duhet të vazhdojë dhe duhet të zgjerohet për një numër shumë më të madh të rejash dhe të rinjsh, pasi granti i dhënë është vërtet i rëndësishëm në nxitjen e iniciativave të biznesit rinor.
- 30% e të intervistuar/ave (n=3) që kishin përfituar nga projekti "Të rinjtë dhe të rejat drejt një profesioni" ishin shumë të kënaqur/a me mbështetjen e ofruar dhe të gjithë kishin arritur të punësoheshin në bizneset ku kishin zhvilluar praktikën. Ata/ato shpreheshin për vazhdimin e këtij projekti dhe zgjerimin e numrit të përfitues/eve.
- 40% e të intervistuar/ave (n=4) që ishin duke përfituar nga projekti "Fillo me një ide fito një internship" theksonin shumë rëndësinë e vazhdimit të trajnimeve të ndryshme për të fituar sa më shumë shprehi dhe aftësi profesionale, me qëllim që të mund të finalizonin me sukses idetë apo projektet që kishin filluar.

Përfundimisht mund të themi se, përsa i takon pikës së dytë të Deklaratës, **Bashkia Tiranë ka ndërmarrë iniciativa tepër konkrete të cilat kanë ndikuar jo vetëm në mbështetjen e të rejave dhe të rinjve për ngritjen e sipërmarrjeve rinore por edhe në punësimin apo aftësimin e tyre profesional.** Në mënyrë të përmbledhur, rezultatet nga puna e bërë në drejtim të plotësimit të këtij angazhimi janë:

- 10,000,000 lekë të shpenzuara për nxitjen e sipërmarrjes rinore dhe mbështetjen e 20 aplikanteve/aplikantëve për fazën e parë 2016-2018 dhe vazhdimi i mbështetjes për një fazë të dytë i konfirmuar gjatë vitit 2018.
- 32 aplikante/aplikantë të trajnuar për idetë më të mira të biznesit në kuadër të Nxitjes së Sipërmarrjes Rinore dhe 20 aplikante/aplikantë të mbështetur me grante në vlerën 500,000 lekë për të filluar apo zgjeruar bizneset e tyre.
- 11 (njëmbëdhjetë) biznese të reja të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Bizneseve, 9 (nëntë) biznese ekzistuese të zgjeruara, si dhe rreth 20 (njëzet) persona të punësuar nga këto subjekte përfituese.
- 2,100,000 lekë të shpenzuara gjatë vitit 2017 në kuadër të punësimit të të rejave dhe të rinjve, për një total prej 15-20 përfituesesh/përfituesish, planifikuar për të rimbursuar punëdhënësit për pagën minimale bruto që u paguhet përfitueseve/përfituesve për gjithë periudhën e zhvillimit të praktikës profesionale

(3-6 muaj), si dhe vazhdimi i mbështetjes për një fazë të dytë i konfirmuar gjatë vitit 2018.

- 2,535,000 lekë të shpenzuara gjatë vitit 2018 në kuadër të nxitjes së ideve kreative dhe aftësimit profesional të të rejave dhe të rinjve përmes internshipit në Bashkinë e Tiranës.
- 8 projekte-ide dhe 8 studime të mbështetura për t'u zbatuar gjatë periudhës së praktikës së punës dhe nga një çmim prej 62,500 lekësh i caktuar për secilin/secilën praktikant/e nëse realizojnë me sukses projektet dhe studimet për të cilat u përzgjodhën.

3.3. ARRITJET NË LIDHJE ME "KRIJIMIN E BORDIT RINOR KËSHILLIMOR TË BASHKISË TIRANË"

Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga Bashkia Tiranë në lidhje me hapat e ndërmarrë për përmbushjen e kësaj pike të pestë të Deklaratës, mund të themi se rezultatet janë pozitive, por gjithsesi përpjekjet duhet të vijojnë më tej. Drejtoria e Rinisë që në vitin tetor 2015 ka krijuar Bordin Rinor Këshillimor, në respektim të Nenit 9 të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore". Ky Bord ka rol këshillues për politikat dhe programet rinore. Përzgjedhja e anëtarësisë është bërë përmes një ftese të hapur, drejtuar organizatave rinore, Këshillave Studentore dhe Presidentëve të gjimnazeve (këta të fundit janë me rotacion sepse ndryshojnë çdo vit). Bordi përbëhet nga 29 të reja dhe 32 të rinj dhe ka përfaqësues edhe nga minoritetet, por duhet theksuar se numri i anëtarësisë dhe përbërja janë të ndryshueshme në bazë vjetore. Megjithatë puna për hartimin e rregullores së Bordit ka filluar vetëm pas dy vitesh nga krijimi i tij. Ky dokument i rëndësishëm që rregullon funksionimin e këtij organi këshillimor dhe që do të përmbajë edhe kriteret e pjesëmarrjes në këtë organ, diversifikimin e anëtarësisë jo vetëm nga pikpamja gjinore, detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve, takimet, si dhe aspekte të tjera të funksionimit, është në përfundim dhe pritet të publikohet së shpejti në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Tiranë.

Bordi Rinor Këshillimor ka luajtur një rol të rëndësishëm në hartimin e PLVR 2018-2020, duke filluar nga grupi i punës i ngritur brenda tij që ka punuar për hartimin e këtij plani, e deri tek diskutimi dhe përmirësimi i draftit përfundimtar të tij.

Çështje të tjera të rëndësishme të ngritura nga Bordi Këshillimor dhe të marra në konsideratë nga Bashkia Tiranë kanë të bëjnë me:

- Ndarjen e buxhetit të rinisë nga ai i sportit – kjo kërkesë është realizuar nga bashkia Tiranë në vitin 2017 dhe buxheti tashmë është i ndarë në dy programe: rini dhe sport.
- Monitorimin e funksionimit të Kartës së Studentit nëpërmjet mekanizmave monitorues përkatës.
- Hapjen e Qendrave Rinore – Bashkia Tiranë ka marrë masat dhe ka transformuar plotësisht 4 biblioteka të lagjeve në qendra rinore multi-funksionale, ndërkohë që është në proces rikonstruksioni i kbibliotekave të tjera. Këtyre të fundit do t'u shtohet dhe Qendra TEN.
- Mbështetjen financiare të organizatave rinore – lidhur me këtë kërkesë Bordi Rinor Këshillimor është sqaruar se të gjitha organizatat rinore kanë të drejtë të aplikojnë sipas rregullores së Këshillit të Kulturës miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak.
- Promovimin e talenteve të reja – në këtë kuadër Bordi Rinor Këshillimor është sqaruar se Bashkia Tiranë prej 3 vitesh zhvillon aktivitete në këtë drejtim, si p.sh.

Tirana Art Fest, Festivali i Teatrit për të Rinj apo Festivali Letrar dhe aktualisht ka filluar edhe programin për të zhvilluar të folurin në publik për të rejat dhe të rinjtë.
- Pasurimin e bibliotekave me fond librash – në lidhje me këtë çështje Bashkia Tiranë ka marrë masa për pasurimin e bibliotekave me libra duke mundësuar sigurimin e afërsisht 17,000 librave për vitin 2017 dhe rreth 18,000 libra gjatë vitit 2018.
- Nevojën për programe për nxitjen e punësimit të të rejave dhe të rinjve – të gjitha çështjet e ngritura nga Bordi Rinor Këshillimor në lidhje me punësimin i janë adresuar dhe janë konsultuar me Drejtorinë e Nxitjes së Punësimit.

Gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave për monitorimin e plotësimit të pikave të Deklaratës, Observatori realizoi dy intervista të thelluara me dy prej anëtarëve të Bordit Rinor Këshillimor. Sipas informacionit të dhënë prej tyre:
- Bordi Rinor Këshillimor është funksional prej vitit 2016
- Përzgjedhja e anëtarëve nuk është bërë në bazë kriteresh apo aplikimi, ata/ato thjesht i janë përgjigjur thirrjes së interesit të lëshuar nga Bashkia Tiranë dhe janë bërë pjesë e këtij Bordi.
- Asnjë nga dy të intervistuarit nuk ishte në gjendje të jepte nje numër të saktë të anëtarësisë dhe përbërjes së saj. Anëtarët kryesisht janë të reja dhe të rinj përfaqësues/e të rrjeteve apo organizatave të ndryshme rinore.
- Një nga të intervistuarit mendon se në përbërjen e Bordit Rinor Këshillimor 70% janë të reja dhe 30% të rinj.
- Nuk ka anëtarë nga minoritetet etnike apo nga grupe të tjera të pafavorizuara, ndonëse disa prej organizatave mbrojnë edhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.
- Njoftimet për mbledhje apo takime bëhen nëpërmjet e-mailit që dërgohet nga Drejtoria e Rinisë, por koha e dërgimit të tyre është e ndryshme, ka raste që njoftimi bëhet një javë para zhvillimit të mbledhjes/takimit, ka raste edhe dy ditë përpara.
- Brenda Bordit nuk ka qartësi në lidhje me përgjegjësitë për të përfaqësuar zërin e të rejave/rinjve, rotacionin në lidhje me këtë përfaqësim, etj. Përgjithësisht diskuton cilido/cilado në varësi të çështjeve që janë në rend të ditës.
- Secili/a anëtar/e mund të ngrejë shqetësime nëpërmjet e-mailit dhe të japë komentet e veta për çështje të caktuara në të njëjtën formë. Në këtë mënyrë u veprua dhe pati rezultat edhe bashkëpunimi për hartimin e PLVR 2018-2020.
- Bordi Rinor Këshillimor ende nuk ka një kalendar të aktiviteteve apo një mekanizëm monitorues të adresimit të shqetësimeve të ngritura. Po kështu edhe rregullorja e funksionimit të tij është ende në proces përgatitjeje.
- Është e rëndësishme që kjo rregullore të përfundojë dhe miratohet sa më parë dhe mbi të gjitha, pikat e saj të zbatohen me korrektësi (psh në drejtim të kohës së mbledhjes, kritereve të përzgjedhjes së çështjeve që do diskutohen apo të anëtarësisë së Bordit, etj).

Si përfundim, mund të themi se Bashkia Tiranë ka hedhur hapa në drejtim të përmbushjes së pikës së pestë të Deklaratës, por ka ende punë për të bërë me qëllim që kjo pikë të adresohet në mënyrën e duhur. Rezultatet në këtë drejtim përmblidhen si në vijim:
- Bashkia Tiranë e ka ngritur Bordin Rinor Këshillimor, i cili shërben si një organ konsultues për politikat dhe çështjet rinore;

- Bordi Rinor Këshillimor ka një anëtarësi të zgjeruar të përbërë kryesisht nga përfaqësues/e të rrjeteve dhe organizatave rinore, grupeve vulnerabël e minoriteteve dhe përbërja e tij aktualishte është nga 29 të reja dhe 32 të rinj.
- Bordi Rinor Këshillimor ka luajtur një rol të rëndësishëm në përgatitjen dhe konsultimin e PLVR 2018-2020, si dhe ka ngritur për diskutim një sërë çështjesh të tjera që lidhen me prioritetet e rinisë, qofshin këto buxhetore, infrastrukturore, logjistike, etj.

4. KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET

4.1 KONKLUZIONET

Në përfundim të përpunimit të të dhënave dhe informacionit të mbledhur gjatë procesit të monitorimit mund të arrijmë në këto konkluzione:

- Bashkia Tiranë, nga momenti i nënshkrimit të Deklaratës "Çfarë duan të rinjtë e Tiranës?" ka ndërmarrë një sërë veprimesh për të trajtuar me prioritet dhe për të përmbushur pesë pikat e kësaj Deklarate.
- Buxheti për rininë është trefishuar, që prej vitit 2015.
- Çështjet e rinisë janë prioritarizuar edhe në terma të organikës së bashkisë, ku ekziston një drejtori me vehte për këtë qëllim "Drejtoria e Rinisë" dhe që nga viti 2017 buxheti për rininë është i ndarë nga buxheti për sportin.
- Programi për Nxitjen e Sipërmarrjes Rinore që ka filluar të zbatohet që në vitin 2016 duket se po jep rezultate pozitive, pavarësisht se ka nevojë për një vlerësim të mirëfilltë të impaktit dhe kosto-efektivitetit të tij. Nga programi i parë kanë përfituar grante në vlerën 500,000 lekë për person 20 të reja dhe të rinj që u seleksionuan përmes konkursit për "Idetë inovatore"; janë regjistruar 11 biznese të reja rinore dhe kanë zgjeruar aktivitetin e tyre 9 të tjera. Afërsisht një numër i njëjtë individësh pritet të përfitojë edhe nga programi i dytë që u miratua për këtë qëllim në vitin 2018.
- 15-20 të reja dhe të rinj kanë përfituar nga programi i nxitjes së punësimit përmes zhvillimit të praktikës mësimore në subjekte të ndryshme, ku më pas edhe janë punësuar, gjatë vitit 2017. Pothuaj i njëjti numër përfituesesh/përfituesish pritet të arrihet edhe me programin e dytë të miratuar për këtë qëllim gjatë vitit 2018.
- 16 të reja dhe të rinj janë duke zhvilluar internshipin në Bashkinë e Tiranës dhe po punojnë për të zbatuar projekt-idetë apo studimet e tyre, në bazë të të cilave u përzgjodhën. Në përfundimin me sukses të tyre pritet që secili/secila të marrë dhe një çmim në vlerën 62,500 lekë.
- Të gjitha bibliotekat janë kthyer në qendra multifunksionale me vendim të Këshillit Bashkiak me nr. 35 dt 29.03.2018. Katër biblioteka lagjesh janë rikonstruktuar plotësisht dhe janë kthyer në Qendra multi-funksionale, duke filluar nga dhjetori 2017, si: Hamit Beqaj, Musine Kokalari, Petro Zheji dhe Misto Treska. Aktualisht kanë filluar punimet në bibliotekën e Njësisë nr 6 dhe 11 dhe në vijim do të fillojnë punimet në bibliotekën e Njësisë nr 2.
- Prej datës 27 Maj 2019, studentët e universiteteve të Tiranës kanë nisur të pajisen me kartën studentore, falë së cilës përfitojnë shërbime falas ose me kosto të reduktuar.

- Është ngritur dhe funksionon Bordi Rinor Këshillimor por për rritjen e efektivitetit të tij ka nevojë të miratohet rregullorja përkatëse ku të përcaktohen kriteret, anëtarësia, detyrat, funksionet, etj.
- Fakti që Bashkia Tiranë ka përgatitur edhe një PLVR 2018-2020, thekson vënien në prioritet të rinisë dhe çështjeve të saj.

4.2. REKOMANDIMET

- Për transparencë, rekomandojmë që ***Bashkia Tiranë të paraqesë në faqen e saj të internetit një tablo të të ardhurave dhe shpenzimeve për çështjet e rinisë, me shifrat përkatëse të planifikuara dhe shpenzuara për periudhën 2016-2018, ku të jepen detaje edhe mbi llojet e projekteve, kohëzgjatjen e tyre, totalin e buxheteve të shpenzuara etj***. Është e rëndësishme që në këtë tablo të shmanget dhënia e shifrave në bllok (p.sh. të natyrës "Shpenzime për Drejtorinë e Rinisë gjithsej xxx lekë"). Kjo pasi, në totalin e shpenzimeve për rininë duhet të ndahen qartësisht shpenzimet e administratës dhe personelit përgjegjës nga veprimet konkrete në mbështetje të çështjeve të të rejave dhe të rinjve të Bashkisë Tiranë. Po kështu edhe ndarja e fondeve të shpenzuara nga totali i buxhetit të bashkisë me të ardhurat dhe shpenzimet nga projektet shtesë të realizuara me buxhete nga donatorët, është e rëndësishme dhe shërben si një tjetër tregues i matjeve të përpjekjeve të bashkisë në këtë drejtim.

- ***Mbështetja e të rejave dhe të rinjve me grante për fillimin apo zgjerimin e bizneseve rinore është domosdoshmëri*** dhe fakti që Bashkia Tiranë e ka vijuar këtë mbështetje me një program të dytë për vitin 2018, nënkupton që rezultatet e programit të parë 2016-2018 kanë qenë pozitive. Për efekt transparence dhe rritje të besimit të të rejave dhe të rinjve që iniciativa të tilla funksionojnë, do të ishte me interes që Bashkia Tiranë të paraqesë në faqen e saj të internetit një informacion të shkurtër bazuar në monitorimin e vazhdueshëm të bërë lidhur me ecurinë e kësaj iniciative, por edhe një monitorim dhe vlerësim të impaktit dhe kosto-efektivitetit të saj. Në këtë informacion do të ishte mirë të evidentohej ecuria e bizneseve të mbështetura, qëndrueshmëria e tyre pas vitit 2018, zgjerimi i tyre, etj., së bashku edhe me vetë opinionet e të 20 të rejave dhe të rinjve që u mbështetën nga kjo iniciativë. Nga monitorimi i deritanishëm i bashkisë rezulton se: 10 prej bizneseve përfituese janë të qendrueshme, të suksesshme dhe kanë bërë punësime; 6 biznese rezultojnë të qendrueshme, por nuk kanë bërë punësime, ndërsa 3 prej bizneseve paraqesin vështirësi në zhvillimin e biznesit. Eksperienca e tyre mund të bëhet publike edhe përmes një emisioni televiziv (apo cikli emisionesh), ku së bashku me promovimin e iniciativës mund të bëhet dhe një promovim i këtyre bizneseve sociale, si nxitje për më shumë të reja dhe të rinj për të aplikuar me ide të reja dhe bashkëkohore. E njëjta transparencë dhe i njëjti monitorim e vlerësim impakti dhe kosto-efektiviteti duhet të realizohet dhe bëhet publik edhe për projektin "Të rinjtë dhe të rejat drejt një profesioni" apo për projektin "Fillo me një ide, fito një internship".

- ***Vlerësimi i impaktit të aktiviteteve të realizuara dhe planifikuar për t'u realizuar në bibliotekat qendra rinore multi-funksionale është i domosdoshëm*** me qëllim që të

mundësohet adresimi në mënyrën e duhur i të gjitha prioriteteve dhe interesave të të rejave dhe të rinjve të qytetit të Tiranës. Po kështu, është shumë e rëndësishme të monitorohet sa dhe si ndikon publikimi on-line i kalendarit të aktiviteteve të planifikuara në këto biblioteka, si dhe se cilat mund të jenë burimet e tjera të informacionit që duhet të vihen në dispozicion me qëllim që të nxiten sa më shumë të reja dhe të rinj për të frekuentuar këto bliblioteka - qendra rinore multifunksionale. Kujdes duhet treguar në mbledhjen e të dhënave dhe vlerësimin e impaktit të funksionimit të tyre veçanërisht për adresimin e prioriteteve të të rejave dhe të rinjve nga grupe të pafavorizuara. Shkëmbimi i eksperiencës dhe koordinimi me Qendrën Rajonale Rinore të Tiranës është gjithashtu një mundësi për të shtuar larmishmërinë e aktiviteteve dhe për të krijuar më shumë mundësi dhe hapësira për të rejat dhe të rinjtë e Tiranës. Nxitja e organizatave jo-qeveritare, sidomos e atyre organizatave që në fokus të punës kanë të rejat dhe të rinjtë, për të shfrytëzuar ambjentet e këtyre qendrave do të mundësojë një larmishmëri aktivitetesh dhe nxitje të pjesëmarrjes e interesit.

- ***Për monitorimin e ecurisë së Kartës Studentore*** Bashkia Tiranë duhet të ngrejë mekanizma të mirëfilltë monitorimi, si edhe të informoj të rinjtë dhe publikun e gjerë për ecurinë e saj.

- ***Për rritjen e efektivitetit të funksionimit të Bordit Rinor Këshillimor*** është e rëndësishme që të respektohet përfaqësimi gjinor, etnik, i grupeve të pafavorizuara, etj. Gjithashtu duhet të përcaktohen detyrat, funksionet dhe përgjegjësitë e anëtarëve, mënyra e përzgjedhjes së çështjeve për diskutim, përfaqësimi, etj. Të gjitha këto duhet të jenë pjesë e rregullores së Bordit e cila duhet të përfundojë dhe bëhet publike sa më parë. Komunikimi me këtë organ këshillimor gjithashtu është shumë i rëndësishëm dhe njoftimet në lidhje me takimet apo mbledhjet e Këshillit Bashkiak duhet të bëhen publike dhe të jepen në kohë. Bordi Rinor Këshillimor duhet të marrë pjesë patjetër në të gjitha mbledhjet e Këshillit Bashkiak ku diskutohen çështjet e rinisë. Gjithashtu Bordi duhet të ketë një mekanizëm monitorues e vlerësues se sa dhe si adresohen çështjet e ngritura prej tij nga ana e Bashkisë, si zgjidhen ato, etj.

5. SHTOJCA

5.1. DEKLARATA "ÇFARË KËRKOJNË TË RINJTË E TIRANËS?"

ÇFARË KËRKOJNË TË RINJTË E TIRANËS?

Zëri i të Rinjve (Youth Voice) – E ardhmja që duam në Shqipëri

(Nëntor 2014 – Nëntor 2015)

I nderuar Z. Kryetar,

Në Tetor 2014, zyra rajonale e UNFPA lançoi fushatën rajonale "Zëri i të Rinjve" në mbështetje të procesit global për hartimin e axhendës së re të zhvillimit Përtej2015. Qëllimi i kësaj fushate është përfshirja e nevojave dhe rekomandimeve të të rinjve në këtë axhendë të re, si edhe në Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm (SDGs). Kësaj fushate iu bashkua edhe Shqipëria, në fillim me 3 organizata jo-qeveritare dhe me mbështetjen e zyrës së UNFPA në vend.

Faza e parë konsistoi në angazhimin dhe pjesëmarrjen e të rinjve në konsultime të gjera në të gjithë Shqipërinë për të marrë zërin e tyre në lidhje me atë se si e duan ata të ardhmen e tyre dhe se cilat janë prioritetet që duhen adresuar në axhendën e re të zhvillimit. Në nivel rajoni, faza e parë mblodhi 80 organizata nga 23 shtete të Europës Lindore dhe Azisë Qendrore (EECA), pjesë e së cilës është edhe Shqipëria.

Faza e dytë e fushatës filloi në Korrik 2015, me rastin e Ditës Botërore të Popullsisë.

Gjatë kësaj faze u krijua Rrjeti shqiptar "Zëri i të Rinjve" që përfshin 11 organizata dhe 2 klube rinore, të cilat janë të specializuara për të punuar në fusha dhe me

fusha dhe me grupe të ndryshme të rinjsh, specifikisht me të rinj nga grupet vulnerabël, mbështetur nga UNFPA Albania dhe koordinuar nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve.

Organizatat dhe të rinjtë vullnetarë po zbatojnë aktivitete në nivel kombëtar përgjatë periudhës Maj-Nëntor 2015.

Aktivitetet e fushatës janë të fokusuara në mbërritjen tek vendimmarrësit lokalë dhe qendrorë për të prezantuar vizionin e të rinjve dhe për të dhënë mesazhe avokuese tek palët e interesuara, vendimmarrësit kombëtarë dhe lokalë, për të nxitur përfshirjen e tyre në planet kombëtare dhe lokale të veprimit dhe buxhetet përkatëse.

Duke marrë shkas nga çështjet që të rinjtë kanë shtruar në takimet konsultuese, mbështetur në një seri dokumetesh strategjike dhe politike[19] dhe, duke u bazuar në të drejtat e njeriut për informim, pjesëmarrje dhe transparencë, sot, të rinjtë e Tiranës, prezantojnë një seri çështjesh në këtë diskutim të hapur me Ju:

1. ***Të trefishohet buxheti për Rininë***

Sipas Prioriteteve të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2013-2015 të Bashkisë Tiranë, një ndër programet e zhvillimit të qytetit Tiranës është "Zhvillimi i Rinisë dhe Sportit".

Ky program përbën **<u>vetëm 1%</u>** të totalit të shpenzimeve të Bashkisë Tiranë.

[19] Plani 4-vjeçar për të rinjtë premtuar nga Z. Erion Veliaj, kryetar i Bashkisë Tiranë; Plani Kombëtar i Veprimit për të Rinjtë 2015-2020; Manifesti i Bashkisë; Zero draft of the outcome document for the UN Summit to adopt the Post-2015 Development Agenda.

Të rinjtë sot (grupmosha 15-29 vjeç) janë **24%** (ose 690,463 nr.)[20] e popullatës së Shqipërisë.

Sipas Vendimit nr. 14, dt 02.05.2012 "Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së aparatit të Bashkisë së Tiranës", misioni i sektorit të Rinisë, një sektor nën varësinë e Drejtorisë së Rinisë dhe Sporteve, është hartimi i politikave dhe planeve të veprimit duke synuar intensifikimin e jetës rinore, zhvillimin e infrastrukturës të ambjenteve rinore me parametra bashkohorë, të cilit i janë përcaktuar një sërë detyrash. *Kjo përbën dhe një ndër 10 pikat e programit për të rinjtë premtuar nga Ju Z. Kryetar i Bashkisë*.

Në bazë të evidencave të buxhetit në vitet e kaluara dhe strukturave të cilat kanë qenë në mbështetje të rinisë kërkojmë **minimalisht të trefishohet** nga niveli që është sot, nga 1% në 3% të totalit të alokimeve ku përfshihet dhe mbështetja për organizatat e shoqërisë civile për të rinjtë. Ajo që ne të rinjtë kërkojmë është:

a) Cili do të jetë buxheti i alokuar për rininë në Bashkinë e Tiranës?

b) Cila do të jetë struktura që do të merret direkt me çështjet e Rinisë?

c) A do të ngrihet një strukturë brenda bashkisë, që do të merret me mbledhjen e informacioneve dhe të dhënave për të rinjtë, me qëllim përdorimin e këtyre informacioneve dhe të dhënave në hartimin e politikave afatgjata për ta?

2. Nxitja e sipërmarrjes rinore

Qëllimi i objektivit strategjik nr. 2 në Planin Kombëtar të Rinisë është rritja e punësimit të të rinjve përmes politikave efektive të tregut të punës, përmirësimit të

[20] Burimi: INSTAT Albania, Janar 2015

kuadrit ligjor, mbështetjes së programeve “start-up” me fokus sipërmarrjet rinore, zgjerimit të kurseve të ofruara nga shkollat e Aftësimit Profesional dhe krijimit të konkurseve që nxisin idetë inovative.

Një tjetër e re në këtë plan është dhe patentimi i ideve apo mbrojtja e bizneseve dhe sipërmarrjes rinore përmes skemës mbrojtëse të patentimit (copyright). Disa prej aktiviteteve të këtij Objektivi, të cilat janë të lidhura me sipërmarrjen e të rinjve, janë planifikuar të realizohen **<u>në bashkëpunim me pushtetin vendor</u>**, si psh: organizimi i konkurseve rajonale «Ide Inovative», me qëllim nxitjen e punësimit të të rinjve dhe sipërmarrjeve rinore.

Duke qenë se nxitja e sipërmarrjes së të rinjve përballet me shumë kufizime si: mungesa e burimeve financiare (niveli i ulët i kapitalit fillestar), mungesa e ambjenteve të përshtatshme për zhvillimin e një biznesi, llojshmëria e pakët e biznesit, aftësitë e kufizuara për të hapur një biznes, lehtësirat e munguara për këtë kategori etj., ***<u>cila është strategjia e Bashkisë së Tiranës për partneritetin dhe bashkëpunimin me bizneset për nxitjen e sipërmarrjes rinore?</u>***

3. Hapja e Qendrave Rinore në zonat periferike.

Sipas Planit Kombëtar të Veprimit për Rininë 2015-2020, Objektivi Strategjik 1 ka në fokus nxitjen dhe pjesëmarrjen e të rinjve në proceset / vendimmarrjet demokratike. Objektivi specifik 1.1 flet pikërisht për forcimin e strukturave dhe kapaciteteve të organizatave rinore dhe, për realizimin e këtij objektivi, një ndër aktivitetet është ngritja e Qendrave Rajonale Rinore (12 në total), të cilat do të jenë njësi të drejtëpërdrejta për organizimin e aktiviteteve dhe shërbimeve për të rinjtë. Në Mars të vitit 2015, Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë inaguroi qendrën e parë Rinore në Tiranë, të cilat janë nën varësinë e Shërbimit Kombëtar për Rininë dhe premtoi se do të hapte nga një qendër rinore për çdo bashki. Ne kërkojmë që minimalisht dy Qendra Rinore të çelen në zonat periferike të Tiranës, ku të rinjtë,

sidomos ato grupe të margjinalizuara apo me nevoja të veçanta dhe që nuk kanë akses në aktivitete kulturore e sportive, do të kenë mundësinë të përfshihen, organizojnë aktivitete dhe argëtohen në një qendër të kompletuar dhe të arritshme në distancë, pa kosto dhe pa qenë e nevojshme të vijnë në qendër të qytetit.

Cili do të jetë ndryshimi midis funksioneve të Qendrave Rajonale Rinore dhe 6 Qendrave Rinore në Bashkinë e Tiranës? Ajo që ne të rinjtë e Tiranës kërkojmë është:

a) Të hapen të paktën 2 qendra rinore në zonat perikferike të Tiranës.
b) Të afishohet në vende publike axhenda e aktiviteteve të qendrave rinore realizuar nga OJF ose organizmat shtetërore dhe jo-shtetërore .
c) Të ofrohen lehtësira dhe ndihmë teknike për aktivitetet rinore, sidomos për grupet vulnerabël e minoritetet.
d) Këto qendra të jenë të hapura për të gjithë të rinjtë, prioritet të kenë organizimet e vetë të rinjve dhe nismat e tyre.

4. Vënia në fuqi e Kartës së të Rinjve dhe Studentit në bashkëpunim me MAS.

Sipas Planit Kombëtar të Veprimit për Rininë 2015-2020, Objektivi Strategjik 2 ka në fokus nxitjen e punësimit të të rinjve përmes politikave efektive. Objektivi specifik 2.6 flet për përgatitjen e Kartës Rinore dhe ekuivalentimin me Kartën Evropiane për Rininë brenda vitit 2016 dhe është specifikuar si një detyrë e MMSR e vetme, pa bashkëpunimin e institucioneve të tjera qendrore apo vendore. Kjo kartë, në vendet Europiane parashikon një gamë shërbimesh lehtësuese për të rinjtë që e zotërojnë.

a) A është Karta e të Rinjve dhe Studentit që do të nxjerrë bashkia e njëjtë me Kartën Rinore që planifikohet në Planin Kombëtar për Rininë?
b) Nëse po, cilat do të jenë funksionet e saj dhe prioritetet që kjo kartë do të sigurojë?
c) Nëse jo, cili do të jetë ndryshimi midis këtyre 2 kartave?

5. Të krijohet Bordi Rinor Këshillimor i Bashkisë, Tiranë.

Sipas Planit Kombëtar të Veprimit për Rininë 2015-2020, Objektivi Strategjik 1 ka në fokus nxitjen dhe pjesëmarrjen në mënyrë gjithëpërfshirëse të të rinjve në proceset/vendimmarrjet demokratike. Objektivi specifik 1.2 flet pikërisht për rritjen e përfaqësimit të të rinjve në proceset vendimmarrëse dhe strukturat e qeverisjes vendore dhe për realizimin e këtij objetivi është planifikuar krijimi i Bordit Rinor Këshillimor në MMSR brenda vitit 2015 dhe **krijimi i Bordit Rinor Këshillimor në strukturat e qeverisjes vendore brenda vitit 2016**, si një strukturë këshilluese nga të rinjtë në të gjitha fazat e vendimmarrjes, hartimit dhe monitorimit të politikave rinore. Duke qenë se politikat qendrore në këtë rast shkojnë në të njëjtën linjë me politikat vendore, të rinjtë e Tiranës kërkojnë të përfaqësohen nga ky Bord Rinor:

- Si është menduar krijimi i këtij Bordi, kriteret e pjesëmarrjes, sa i aksesueshëm, ku mund te merret informacioni i duhur publik dhe transparent?
- Diçka më shumë për rregulloren, programin, shpeshtësinë e mbledhjes, kompetencat?

Në përmbledhje të Deklaratës sonë, **kërkesat tona janë:**

1. Buxheti i alokuar për rininë të trefishohet nga 1% në 3%.

2. Të ngrihet një instrument publik, transparent, që tregon iniciativat dhe sipërmarrjet rinore të mbështetura nga bashkia.
3. Të hapen të paktën 2 qendra rinore në zonat periferike të Tiranës.
4. Vënia në fuqi e Kartës së të Rinjve dhe Studentit në bashkëpunim me MAS.
5. Të krijohet Bordi Rinor Këshillimor i Bashkisë Tiranë.

Në mbështetje të ecurisë së procesit dhe realizimit të këtyre kërkesave, mendojmë që të ndiqen parimet e mëposhtme:

- Përfshirja qartësisht në planet e zhvillimit të Bashkisë.
- Vensoja e një mekanizëm komunikimi, informimi i vazhdueshëm dhe transparent si elemente kyç për një proces efektiv dhe bilateral ndërmjet Bashkisë dhe komunitetit të të rinjve të Bashkisë Tiranë, që do të mundësojë pjesëmarrje të të rinjve, transparencë dhe llogaridhënie.
- Pjesëmarrja e qenësishme e të rinjve në hartimin, buxhetimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave dhe programeve që ndikojnë në jetën tonë.
- Akses të plotë në proces si një element thelbësor për plotësimin e këtyre kërkesave.

Ju falenderojmë për konfirmimin e takimit me përfaqësues të rrjetit tonë për të diskutuar më tej mbi kërkesat tona të paraqitura në këtë deklaratë.
Në përfaqësim të Rrjetit shqiptar "Zëri i të Rinjve":

Elma Tërshana
Drejtore ekzekutive
Observatori për të Drejtat e Fëmijëve

Andi Rabiaj
Përgjegjës
Rrjeti Y-PEER, Albania

5.2. PLANI I MONITORIMIT TË DEKLARATËS

PLAN MONITORIMI I DEKLARATËS

"Çfarë Kërkojnë të Rinjtë e Tiranës?

Nënshkruar nga Z. Erion Veliaj, Kryetari Bashkisë së Tiranës

Në 9 Nëntor 2015, të rinjtë dhe rrjeti i organizatave "Zëri i të rinjve" realizuan një takim me Z. Erion Veliaj, Kryetar i Bashkisë së Tiranës. Qëllimi i takimit ishte prezantimi i një serie çështjesh me rëndësi për të rinjtë për t'u realizuar nga Bashkia e Tiranës. Çështjet e ngritura në Deklaratë ishin përzgjedhur me rëndësi dhe prioritet nga vetë të rinjtë nga takimet e ndryshme konsultuese të oganizuara me vendimmarrësit lokalë dhe qendrorë për të prezantuar vizionin e të rinjve dhe për të dhënë mesazhe avokuese tek palët e interesuara, vendimmarrësit kombëtarë dhe lokalë, për të nxitur përfshirjen e tyre në planet kombëtare dhe lokale të veprimit dhe buxhetet përkatëse.

Përgjatë takimit, Z. Erion Veliaj nënshkroi Deklaratën për angazhimin e Bashkisë së Tiranës në 5 çështje prioritare për të rinjtë[21], si më poshtë:

1- Trefishimi i buxhetit për të rinjtë
2- Nxitja e sipërmarrjes rinore
3- Hapja e qëndrave rinore në zonat periferike
4- Vënia në fuqi e Kartës së të Rinjve dhe Studentit në bashkëpunim me MASR

[21] Deklarata mbi prioritetet e të rinjve e nënshkruar nga Z. Erion Veliaj, Kryetar i Bashkisë Tiranë gjendet në Shtojcën A.

5- Forcimin e Bordit Rinor Këshillimor të Bashkisë Tiranë

Përgjatë periudhës Tetor- Dhjetor 2018, rrjeti i organizatave "Zëri i të rinjve" do të monitoroj zbatimin e angazhimeve të Bashkisë Tiranë.
Tabela A: Angazhimet e Bashkisë Tiranë për të rinjtë, sipas Deklaratës nënshkruar me rrjetin "Zëri i të rinjve", në 9 Nëntor 2015

NR.	ÇËSHTJET	BASELINE	SYNIMIT/ TARGET	MJETET E MONITORIMIT	PYETJET MONITORUESE
1.	**Të trefishohet buxheti për Rininë**	Totali i shpenzimeve të Bashkisë së Tiranës (korente dhe kapitale) në lekë, për këtë program nga viti *2013 në vitin 2015* ka ardhur **<u>në rënie</u>**, praktikisht: - **110,753 ALL në vitin 2013** në **80,068 ALL në vitin 2015.** - Ky program përbën **<u>vetëm 1%</u>** të totalit të shpenzimeve të Bashkisë Tiranë.	Në bazë të evidencave të buxhetit në vitet e kaluara dhe strukturave të cilat kanë qenë në mbështetje të rinisë është kërkuar **<u>minimalisht trefishimi</u>** nga 1% në 3% i totalit të alokimeve ku përfshihet dhe mbështetja për organizatat e shoqërisë civile për të rinjtë.	• Buxheti i Bashkisë së Tiranës për vitet 2016, 2017 dhe 2018.	• Cili është buxheti i alokuar për rininë në Bashkinë e Tiranës në vitet 2016 - 2017 - 2018? • Cila është struktura që angazhohet direkt me çështjet e rinisë? • A ka një strukturë brenda bashkisë, që merret me mbledhjen e informacioneve dhe të dhënave për të rinjtë, me qëllim përdorimin e këtyre informacioneve dhe të dhënave në hartimin e politikave afatgjata për ta? • Cilat janë programet, shërbimet për të rinjtë që ka mbështetur Bashkia e Tiranës?
2.	**Nxitja e sipërmarrjes rinore**	Nxitja e sipërmarrjes së të rinjve përballet me shumë kufizime si: mungesa e burimeve financiare (niveli i ulët i kapitalit fillestar), mungesa e ambienteve të përshtatshme për zhvillimin e një biznesi, llojshmëria e pakët e biznesit, aftësitë e kufizuara për të hapur një biznes, lehtësirat e munguara për këtë kategori etj.	Patentimi i ideve apo mbrojtja e bizneseve dhe sipërmarrjes rinore përmes skemës mbrojtëse të patentimit (copyright). **Organizimi i konkurseve «Ide Inovative»,** me qëllim nxitjen e punësimit të rinjve dhe sipërmarrjeve rinore në bashkëpunim me pushtetin vendor.	• Informacione nga Bashkia e Tiranës në lidhje me konkurset për ide inovative.	• Cila është strategjia e Bashkisë së Tiranës për partneritetin dhe bashkëpunimin me bizneset për nxitjen e sipërmarrjes rinore?
3.	**Hapja e Qendrave**	Në Mars të vitit 2015, Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë (sot	**Të hapen minimalisht dy Qendra Rinore në zonat periferike të Tiranës,**	• Informacione nga Qëndrat rinore.	• A janë hapur Qëndra rinore në zonat periferike të Tiranës?

	Rinore në zonat periferike.	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale) inaguroi qendrën e parë Rinore në Tiranë, e cila është nën varësinë e Shërbimit Kombëtar për Rininë.	ku të rinjtë, sidomos ato grupe të margjinalizuara apo me nevoja të veçanta dhe që nuk kanë akses në aktivitete kulturore e sportive, do të kenë mundësinë të përfshihen, organizojnë aktivitete dhe argëtohen në një qendër të kompletuar dhe të arritshme në distancë, pa kosto dhe pa qenë e nevojshme të vijnë në qendër të qytetit.	• Anketim me të rinjtë që kanë përfituar nga aktivitetet e qëndrës rinore.	• A është afishuar në vende publike axhenda e aktiviteteve të qendrave rinore realizuar nga OJF ose organizmat shtetërore dhe jo-shtetërore? • A ofrohen lehtësira dhe ndihmë teknike për aktivitetet rinore, sidomos për grupet vulnerabël dhe minoritetet? • A janë të hapura këto qëndra për të gjithë të rinjtë, prioritet të kenë organizimet e vetë të rinjve dhe nismat e tyre? • Cilat janë aktivitetet që kanë zhvilluar për të rinjtë këto qëndra? • A i kanë shërbyer këto qëndra interesave dhe prioriteteve të të rinjve?
4.	**Vënia në fuqi e Kartës së të Rinjve dhe Studentit në bashkëpunim me MASR**	N/A	Sipas Planit Kombëtar të Veprimit për Rininë 2015-2020, Objektivi Strategjik 2 ka në fokus nxitjen e punësimit të rinjve përmes politikave efektive. Objektivi specifik 2.6 flet për **përgatitjen e Kartës Rinore dhe ekuivalentimin me Kartën Evropiane për Rininë brenda vitit 2016**. Kjo kartë, në vendet Europiane parashikon një gamë shërbimesh lehtësuese për të rinjtë që e zotërojnë.	• Informacion nga Bashkia e Tiranës mbi Kartën e të rinjve dhe studentit	• A e ka nxjerrë Bashkia e Tiranës Kartën e të Rinjve dhe Studentit? Nëse po, a janë këto karta të njëjta me Kartën Rinore që planifikohet në Planin Kombëtar për Rininë? Nëse jo, cili është plani i Bashkisë së Tiranës për të arritur këtë gjë?
5.	**Krijimi i Bordit Rinor Këshillimor të Bashkisë Tiranë**	N/A	**Krijimi i Bordit Rinor Këshillimor në Bashkinë Tiranë brenda vitit 2016**, si një strukturë këshilluese nga të rinjtë në të gjitha fazat e vendimmarrjes, hartimit dhe monitorimit të politikave rinore.	• Informacion nga Bashkia Tiranë mbi Bordin Rinor Këshillimor • Kalendari i aktiviteteve, veprimtarisë,	• Si është krijuar Bordi rinor këshillimor në Bashkinë Tiranë? (Kriteret e pjesëmarrjes, numri i anëtareve, aksesueshmëria, Marrja e informacionit të duhur publik dhe transparent,

				programeve dhe çështjeve që kanë ngritur të rinjtë në Bordin Rinor Këshillimor	diversiteti i të rinjve pjesëmarrës). • Cila është rregullorja, programi, shpeshtësia e mbledhjes dhe kompetencat e anëtarëve të Bordit? • Cilat janë çështjet që kanë ngritur të rinjtë në takime, dhe sa janë marrë ato në konsideratë nga Bashkia? • Sa ka ndikuar Bordi Rinor Këshillimor i Bashkisë Tiranë në vendimmarrjen për çështjet me prioritet për ta?

5.3. PYETËSORI I TË RINJVE

Numër serie i pyetësorit

C.1 Lagjja / Zona:

C.2 Bashkia:

C.3 Qarku:

C.4 Adresa e saktë e vendndodhjes:

C.5 Data e intervistës: / / 2018

Koha e fillimit të intervistës: Koha e mbarimit:___:___ Kohëzgjatja: _____ *min*.

Emri i Intervistuesit ID (e Intervistuesit) Fakultative

_____

Informacione të Përgjithshme

A1. Gjinia: ☐ Femër ☐Mashkull

A2. Mosha: ☐< 16☐16-19 vjeç ☐20-29 vjeç

A3. Gjendja Civile: ☐ Beqare ☐Bashkëjetoj ☐E Martuar ☐E Divorcuar ☐Refuzoj/Nuk ka përgjigje

A4. Me kë jetoni?

a) Vetëm b)Bashkëshortin/partnerin c)Fëmijët
d) Motrat/Vëllezërit e) Prindërit f) Prindërit e partnerit /bashkëshortit
g)Të tjerë

A5. Arsimi:

☐Fillor ☐9-vjeçar ☐ Shkollë e mesme ☐Shkollë e lartë ☐ Pasuniversitar

A6. Punësimi:

☐I/e papunë ☐Student/e ☐Me kohë të Plotë ☐ Me kohë të Pjesshme
☐I/e vetëpunësuar

A7. Përkatësia etnike: A i përket një grupi etnik të caktuar (p.sh. komunitetit rom, egjiptian)?: ☐Po ☐Jo ☐ Nuk ka përgjigje

A7. a. Nëse po, ju lutem specifikoni _____

A8. Lagjja: ☐ XXXX (A) ☐ YYYYY (B) ☐ ZZZZZZZ (C)

A9. Sa shpesh keni kontakte me Bashkine Tirane?

☐Çdo ditë ☐Të paktën 3 herë në javë ☐Të paktën 1 herë në javë
☐Të paktën 1 herë në muaj ☐Rrallë (me raste)

A10 . Çfarë mendimi keni per programet e te rinjve qe ofron Bashkia Tiirane? A janë ato:

☐Të mjaftueshme ☐Të kufizuara ☐Nuk e di ☐Nuk ka përgjigje

A11. Jepni sugjerimin tuaj; ku duhet të fokusohet me shumë puna e Bashkisë Tiranë në raport me të rinjtë.

Kjo rubrikë u dedikohet vetëm individëve që kanë përfituar grante nga Bashkia Tiranë ose janë pjesë e ndonjë projekti të implementuar nga Bashkia e Tiranës.

B1. Bëni një përshkrim të shkurtër të aktivitetit të biznesit tuaj, që e keni përfituar si grant nga Bashkia Tiranë.

B2. Cili është ambjenti ku zhvilloni biznesin tuaj aktualisht?

B3.Si i keni përdorur fondet e marra nga Bashkia Tiranë deri më tani?

B4. Keni filluar të keni fitime? Nëse jo, cila është arsyeja?

B5. Keni punësuar persona të tjerë? Nëse po, sa?

B6. Me sa biznese të tjera keni bashkëpunuar gjatë këtyre muajve (furniturë, konsulent etj)?

B7.A keni patur deri në këto momente probleme me strukturat tatimore / ligjore?

B8.Cilat janë vështirësitë më të mëdha me të cilat jeni përballur gjatë hjapjes së biznesit tuaj?

C. Bëni një përshkrim të shkurtër të eksperiencës tuaj me Bashkinë e Tiranës nqs keni përfituar nga një tjetër program, përveç atij të granteve për biznes.

_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____

Faleminderit që plotësuat këtë pyetësor!